



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në “Menaxhim”**

**ofruar nga**

**Universiteti Europian i Tiranës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Denada Liça

2. Prof. Asoc. Dr. Gentjan Mehmeti

Gusht 2025

**Tabela përmbledhëse për programin e studimit me karakter profesional në:  
"Menaxhim"**

1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi me karakter profesional në "Menaxhim"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhë Nr. 554, datë 11.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR Nr. 2484/1, datë 21 08.2023
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMAS Nr. 131, datë 15.07.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 13, datë 25 02.2022
8	Cikli i studimit:	
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/ 4 simestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 i kornizës kombëtare
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022 2023 15 PAE / 4PAK 2023-2024 21 PAE / 2 PAK 2024-2025 19 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 16 studentë 2023-2024 18 studentë 2024-2025 19 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)**

Universiteti European i Tiranës (UET), i themeluar në vitin 2006, është një institucion privat i arsimit të lartë, i licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe i akredituar institucionalisht. UET është një universitet i profilit të plotë që ofron programe në të tre ciklet e studimeve dhe në nivele të ndryshme të kualifikimeve, në përputhje me Kornizën Kombëtare dhe Evropiane të Kualifikimeve.

Programi i Studimit me Karakter Profesional në “Menaxhim” ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit dhe është miratuar për hapje sipas Urdhërit të çeljes nga MASR nr.554 date 11.09.2018. Ky program është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2018–2019 si program me kohë të plotë dhe kohëzgjatje 2-vjeçare, i klasifikuar në nivelin 5 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Ai synon zhvillimin e njohurive bazë teorike dhe kompetencave praktike në fushën e menaxhimit, të orientuara drejt kërkesave të tregut të punës dhe formimit profesional të studentëve. Ky program u akreditua për herë të parë në vitin 2022 sipas vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.13 datë 25.02.2022 me një kohëzgjatje prej 3 vite akademike.

Programi përmban 120 kredite ECTS dhe integron përmbajtje mësimore me natyrë ndërdisiplinore dhe praktike, përfshirë edhe komponentin e detyrueshëm të praktikës profesionale në bashkëpunim me kompani e institucione partnere. Struktura kurrikulare është e ndërtuar sipas një metodologjie me qendër studentin, duke synuar zhvillimin e aftësive për punësim të menjëhershëm.

Departamenti përgjegjës për programin përbëhet nga staf akademik me kualifikime të larta, ku shumica e stafit efektiv dhe të ftuar zotëron grada shkencore dhe përvojë në fushat përkatëse të menaxhimit dhe administrimit të bizneseve. CV-të e pedagogëve tregojnë angazhim në kërkime shkencore, trajnime të vazhdueshme dhe pjesëmarrje në aktivitete zhvillimore dhe projekte kombëtare apo ndërkombëtare.

Raporti i vlerësimit të brendshëm evidenton mekanizmat funksionalë për sigurimin e cilësisë së programit, ndërsa identifikon nevojën për përmirësime të mëtejshme në ndarjen më të qartë të strukturave mësimore ndërmjet ciklit profesional dhe atij bachelor, rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në mobilitet, si dhe adresimin strategjik të rënies së numrit të regjistrimeve në vitet e fundit.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

**Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)**

Mbështetur në VKM nr. 109 datë 15.02.2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit. Gjithashtu ASCAL ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për akreditimin e Programit të Studimit me Karakter Profesional në “Menaxhim”. Grupi i jashtëm i vlerësimit përbëhet si më poshtë:

1. Dr. Denada Liça
2. Prof. Asoc. Dr. Gentjan Mehmeti
3. Msc. Anilda Beqiraj, Koordinator teknik i ASCAL.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ekspertët përgatitën draft vlerësimin shoqëruar me pyetjet për pjesët që kërkonin qartësim të mëtejshëm dhe/ose verifikim të cilat u kryen gjatë vizitës në IAL në datat 21-22 Maj, 2025. Gjatë ditëve të vizitave në IAL u kryen diskutimeve intensive dhe proaktive mes GVJ dhe drejtuesve, pedagogëve, anëtarëve të GVB-së, studentëve, stafit administrativ, etj. Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave, komenteve për draft, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për cdo kriter që i referohet standartit për Programi e Studimit me Karakter Profesional në “Menaxhim”. Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analize mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

GVJ vlerësoi infrastrukturën e institucionit, laboratorët, auditorët, mjetet didaktike dhe sistemet e menaxhimit të informacionit. Vëmendje e veçantë iu kushtua funksionalitetit të mekanizmave të sigurimit të cilësisë, përputhshmërisë së kurrikulës me nivelin 5 të KKK-së, procesit të vlerësimit të studentëve, si dhe funksionimit të praktikës profesionale.

Procesi u karakterizua nga bashkëpunim i mirë institucional dhe transparencë e plotë në vënien në dispozicion të informacionit. GVJ përfundoi vlerësimin duke hartuar një raport përfundimtar me analiza, gjetje, konkluzione dhe rekomandime konkrete për përmirësim të mëtejshëm të programit.



## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.13, datë 25.02.2022 janë:

1. Institucioni të rishikojë raportin ndërmjet ngarkesës teorike dhe asaj praktike të lëndëve, me qëllim rritjen e përfshirjes së orëve praktike dhe përshtatjen e këtij raporti në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për programet e studimit me karakter profesional.
2. Institucioni të rishikojë planin mësimor duke i dhënë një peshë më të madhe lëndëve të formimit profesional.
3. Institucioni të rishikojë kurrikulën e programit të studimit, në mënyrë që studentët të fitojnë aftësi dhe kompetenca praktike e profesionale, të përshtatshme me nivelin e këtij programi.
4. Institucioni të rrisë numrin e personelit akademik me eksperiencë dhe kualifikime profesionale në fushën specifike të këtij programi studimi.
5. Institucioni të pasurojë fondin e bibliotekës me literaturë të përshtatshme për nivelin e edukimit profesional që ofron ky program.
6. Institucioni të hartojë një analizë të thelluar lidhur me prirjet dhe ndryshimet dinamike në profilin e Menaxhimit, me qëllim forcimin e avantazheve konkurruese të këtij programi në raport me të tjerët në këtë fushë.
7. Institucioni të orientojë studentët e këtij programi drejt zhvillimit të aftësive praktike dhe përfitimit të kualifikimeve që përputhen me kërkesat e tregut të punës.
8. Institucioni të krijojë mekanizma të qëndrueshëm për ndjekjen e alumnit në tregun e punës, në funksion të rritjes së interesit dhe kërkesës për këtë program studimi.

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Bazuar në raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionin shoqërues të dorëzuar nga institucioni, si dhe në vëzhgimet e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës në terren, konstatohet sa vijon lidhur me Plotësimin e Rekomandimeve të Bordit të Akreditimit sipas Vendimit Nr.13, datë 25.02.2022.

1. Rishikimi i raportit ndërmjet ngarkesës teorike dhe praktike është pasqyruar në kurrikulën e re të programit, ku është rritur pesha e praktikave profesionale dhe komponentëve të lidhur me aftësimin praktik të studentëve. Gjithashtu, janë përfshirë orë praktike në një numër më të madh lëndësh. Edhe pse raporti teori praktikë në dokumentacione është sipas parashikimeve të akteve nënligjore në nivelin 50%/50%, kjo ndarje është artificiale e cila nuk mbështetet në organizimin e moduleve të cilët të jenë të lidhur një mësimdhënie më praktike.



2. Plani mësimor i programit është rikonceptuar për të forcuar formimin profesional. Dokumenti i planit mësimor tregon një rritje të përqindjes së lëndëve me karakter praktik dhe aplikativ.
3. Kurrikula e programit është ndryshuar, duke synuar zhvillimin e kompetencave praktike dhe profesionale që kërkohen në tregun, por megjithë përpjekjet e institucionit, programi i studimit përsëri ruan karakteristikat (natyra e lëndëve, zhvillimi i mësimit) e nivelit të një programi të ciklit të parë Bachelor studimesh, duke tejkaluar nivelin e programit në fjalë.
4. Stafi akademik i programit përfshin aktualisht pedagogë me eksperiencë të dokumentuar në sektorin privat dhe publik të menaxhimit, si dhe me përfshirje aktive në trajnime dhe projekte profesionale. Ka pasur një përpjekje për të rritur numrin e pedagogëve me profil profesional.
5. Fondi i bibliotekës është pasuruar me tituj të rinj në fushën e menaxhimit dhe material didaktik për nivelin profesional. Gjithashtu, studentëve u është mundësuar akses në platforma elektronike për literaturë dhe mjete interaktive mësimore.
6. Analiza mbi prirjet e tregut në fushën e Menaxhimit është zhvilluar dhe përfshin të dhëna mbi tendencat e punësimit, kërkesat për kompetenca dhe përshkrimet e profileve të punës për profesionet përkatëse. Megjithatë, studimi i tregut mbetet në një nivel të përgjithshëm duke mos u fokusuar në forcimin e avantazheve konkurruese të programit.
7. Orientimi i studentëve drejt aftësive praktike realizohet përmes trajnimeve, seminareve, praktikave të strukturuar dhe bashkëpunimit me kompani dhe institucione. Dokumentacioni tregon për angazhime të ndryshme në këtë drejtim.
8. Mekanizmat për ndjekjen e alumnit janë në zhvillim dhe janë ndërmarrë hapa fillestarë për krijimin e një baze të dhënash të alumnit dhe kontaktet me ta për qëllime statistike dhe feedback mbi karrierën pas diplomimit.



**PËRGJIGJE NË LIDHJE ME “KOMENTE NË LIDHJE ME KONSTATIMET E  
EKSPERTËVE TË JASHTËM NË DRAFT RVJ”**

Përgjigja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) në lidhje me shkresën e dërguar nga Universiteti Europian i Tiranës (UET) për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin në proces akreditimi, Diplomë Profesionale në “Menaxhim” ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut ka konsideruar hapat e procesit të deritanishëm. GVJ, pasi u njoh nga koordinatorja e ASCAL, me shkresën dërguar nga Universiteti Europian i Tiranës me Nr. 271/3, datë 29/07/2025, me lëndë “Kthim përgjigje shkresës suaj nr 271/2 prot, datë 24/07/2025”, pasi vlerësoi me kujdes pikat për të cilat Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) i ka dhënë përgjigje gjetjeve tona në lidhje me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, jep argumentet sa më poshtë vijon:

1. Në lidhje me Standartin I.1, Kriteri 3, **“Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij”**, GVJ gjykon se komenti i bërë nga GVB justifikon përmbushjen e këtij kriteri.
2. Në lidhje me Standartin I.1, Kriteri 4, **“Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe”**, GVJ gjykon se komenti i bërë nga GVB justifikon përmbushjen e këtij kriteri.
3. Në lidhje me Standartin II.1, Kriteri 3, **“Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit”**, GVJ ka konstatuar një mungesë rakordimi midis raportimit të GVB dhe informacionit që vetë raporti i tyre referon përmes referencave të vëna në dispozicion duke mos përmendur drejt objektivat që programi ka konceptuar dhe që janë pasqyruar në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim, Pika II: Objektivat e Programit të Studimit dhe Rregullore e Programit të studimit, Pika 3,3: Objektivat a-g. Në këtë kuptim GVJ mendon se komenti nuk i jep përgjigje kësaj mospërputhje të bërë nga vetë GVB. Për këtë GVJ i qëndron komentit të bërë në RVJ.
4. Në lidhje me Standartin II.2, Kriteri 2, **“Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj”**, GVJ qartëson se kriteri përcakton

qartësisht nevojën për personel ndihmës akademik/administrativ dhe dokumentim i numrit apo përbërjes së tyre edhe pse në nivel institucioni nuk është paraqitur në nivel të ngarkesës së mbuluar në programin Diplomë Profesionale në Menaxhim. Gjithashtu GVB ka referuar si dokumenta referues: Referenca 32: “Lista e subjekteve dhe Institucioneve Bashkëpunuese për Programin dhe Praktikat Profesionale” dhe Referenca 32.2: Formulari i Vetëvlerësimit të Studentit të cilat nuk qartësojnë plotësimin e këtij kriteri. Megjithatë GVJ ka gjykuar, duke kërkuar për evidenca në referencën Tabela Përmbledhëse, respektivisht Tabela nr. 8 ku numri i personelit ndihmës akademik dhe administrativ jepet në nivel institucioni. Dokumenti “Komente në lidhje me konstatimet e ekspertëve të jashtëm në draft RVJ”, i ofruar nga GVJ sugjeron për të rikonsideruar Tabelën nr. 8 si dokument referues ku përsëri informacioni mbetet në nivel institucioni pa sjellë fakte të tjera sesi ky staf i dedikohet programit dhe sesi formimit i tij është ose jo në përputhje me nevojat e programit. Për këtë GVJ i qëndron komentit të bërë në RVJ.

5. Në lidhje me Standartin II. 3, Kriteri 4, **“Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara”**, GVJ nuk mendon se informacioni i ofruar nga GVJ përmes dokumentit “Komente në lidhje me konstatimet e ekspertëve të jashtëm në draft RVJ”, përbën fakte të mjaftueshme për plotësimin e këtij kriteri. GVJ e ka evidentuar në raport, ekzistencën e programeve lëndore (syllabuse) por ka vënë në pah faktin se qoftë nga referencat e vëna në dispozicion në raport, qoftë nga vizita në institucion respektivisht në takimet me stafin akademik dhe studentët rezultojnë se elementët e ndërtimit të syllabuseve si dhe realizimi praktik i këtyre elementëve, janë ndërtuar dhe aplikuar për dy cikle studimi njëkohësisht si Bachelor dhe program profesional dhe disa programe studimi, duke çënuar qëllimin dhe objektivat e programit. Për këtë GVJ i qëndron komentit të bërë në raportin e vlerësimit të jashtëm.
6. Në lidhje me Standartin II 4, Kriteri 7, **“Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK”**, GVJ gjykon se informacioni i ofruar nga dokumenti “Komente në lidhje me konstatimet e ekspertëve të jashtëm në draft RVJ”, nuk mund të sjellë ndryshime për praktikën e aplikuar tashmë për këtë program. Ndërtimi i syllabuseve duhet të respektojë natyrën, elementët, objektivat dhe rezultatet e pritura për një nivel



studimi që i përket Kornizës 5 të Kriteve Shtetërore të Kualifikimit (KShK). Në të kundërt kërkesat ligjore nuk do të diferencin programet e studimit në nivele me objektiva, qëllime dhe kritere të mirëpërcaktuara për të siguruar garantimin e përfundimit të njohurive në përputhje me to. Për këtë GVJ i qëndron komentit të bërë në raportin e vlerësimit të jashtëm.

7. Në lidhje me Standartin III.1, Kriteri 1, **“Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni”**, GVJ gjykon se institucioni i UET, ka përcaktuar formën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive si leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura, por ato zhvillohen sëbashku me studentët e programeve bachelor. Komenti i bërë nga GVB në lidhje me faktin se mësimi i përbashkët në lidhje me orët e leksioneve nuk çënon formimin e studentit të programit pasi orët e seminareve zhvillohen në mënyrë të diferencuar, mendojmë se nuk justifikon përmbushjen e këtij kriteri. Marrja e njohurive në orët e leksionit duke ndjekur këtë logjikë do të çënojë ose programin e Diplomës Profesionale ose atë të Programit Bachelor. Për këtë GVJ i qëndron komentit të bërë në raportin e vlerësimit të jashtëm.
8. Në lidhje me Standartin III.3, Kriteri 4, **“Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen”**, GVJ gjykon se komenti i bërë nga GVB justifikon përmbushjen e këtij kriteri.
9. Në lidhje me Standartin III.4, Kriteri 1, **“Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve”**, GVJ gjykon se komenti i bërë nga GVB justifikon përmbushjen e këtij kriteri.
10. Në lidhje me Standartin IV. 1, Kriteri 2, **“Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi”**, GVJ mendon se dokumentat referues në raportin e GVB, tregojnë formularë apo tabela të ngarkesës respektive totale të stafit pa evidentuar ngarkesën e stafit për programin e studimit. Gjithashtu nga komenti i dokumentit “Komente në lidhje me konstatimet e ekspertëve të jashtëm në draft RVJ”, thuhet se mund të ofrohen të dhëna të tjera, por duhet theksuar se afati kohor për të plotësuar të dhënat ka kaluar dhe ato nuk janë plotësuar me të dhëna të tjera në lidhje me plotësimin e kriterit. Për këtë GVJ i qëndron komentit të bërë në raportin e vlerësimit të jashtëm.



11. Në lidhje me Standartin IV. 1, Kriteri 5, **“Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit”**, GVJ ka gjykuar duke kërkuar për evidenca të vlefshme si psh referenca: Tabela Përmbledhëse, respektivisht Tabela Nr. 8, ku numri i personelit ndihmës akademik/ administrativ jepet në nivel institucioni, pasi referenca e vënë në dispozicion në rastin e argumentimit të këtij kriteri është pasqyrimi i infrastrukturës në shërbim të programit të studimit. Pavarësisht kësaj, stafi ndihmës akademik/administrativ jepet në nivel institucioni. Për këtë GVJ i qëndron komentit të bërë në raportin e vlerësimit të jashtëm.
12. Në lidhje me Standartin IV. 1, Kriteri 8, **“Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale”**, GVJ gjykon se komenti i paraqitur në dokumentin “Komente në lidhje me konstatimet e ekspertëve të jashtëm në draft RVJ”, pasqyron një riorganizim të informacionit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, duke pranuar se mund të ofrojë dokumentacion shtesë, por praktikisht ato nuk ka vënë në dispozicion të dhëna të tjera në lidhje me plotësimin e kriterit. Për këtë GVJ i qëndron komentit të bërë në raportin e vlerësimit të jashtëm.
13. Në lidhje me Standartin V. 5, Kriteri 2, **“Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme”**, GVJ gjykon se komenti i paraqitur në dokumentin “Komente në lidhje me konstatimet e ekspertëve të jashtëm në draft RVJ”, në lidhje me plotësimin e Standarti V. 5, Kriteri 2 është riorganizuar dhe plotësuar sa i takon angazhimit të realizimit të këtij kriteri.
14. Në lidhje me Standartin V. 5, Kriteri 3, **“Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.”** GVJ gjykon se komenti i paraqitur në dokumentin “Komente në lidhje me konstatimet e ekspertëve të jashtëm në draft RVJ”, në lidhje me plotësimin e Standarti V. 5, Kriteri 3 është riorganizuar dhe plotësuar sa i takon angazhimit të realizimit të këtij kriteri.



15. Në lidhje me Standarti V. 6, Kriteri 4, “Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse”, GVJ gjykon se nga vlerësimi i Raportit të GVB, Zyra e Karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. GVJ gjykon se komenti i paraqitur në dokumentin “Komente në lidhje me konstatimet e ekspertëve të jashtëm në draft RVJ”, në lidhje me plotësimin e Standarti V. 6, Kriteri 4 është riorganizuar dhe plotësuar sa i takon angazhimit të realizimit të këtij kriteri.



## Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Menaxhim”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit me karakter profesional 2-vjeçar në Menaxhim, i ofruar nga Departamenti i Manaxhimit dhe Marketingut në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit të Universitetit Europian të Tiranës (UET), është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehura në planin strategjik të tij.</p> <p>Strategjia institucionale nënvizon se programi ka për qëllim “aftësimin e studentëve me njohuri teorike dhe me orientim të theksuar praktik, në funksion të përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të tregut të punës”. Kjo përputhshmëri është e reflektuar qartë në formulimin e objektivave të programit dhe në strukturën e tij. Ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri. Ai ruan dhe konsolidon vlerat akademike e kulturore kombëtare.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>GVJ konstatoi që ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e UET ku në qendër është studenti dhe kjo gjë u konstatua gjatë takimeve me vetë studentët dhe stafin akademik.</p> <p>UET ka vendosur në qendër të misionit të tij “formimin e qytetarëve të përgjegjshëm, me aftësi për të vepruar në shoqëri dhe ekonomi”. Ky program reflekton këtë qasje duke integruar komponentë si edukimi praktik dhe ndërveprimi me tregun, çka u konstatua edhe gjatë takimeve të GVJ me studentët dhe stafin. Në këtë kuadër, lëndët si “Komunikim organizativ” dhe “Menaxhimi i burimeve njerëzore” kontribuojnë në ndërtimin e këtyre aftësive.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e	<p>Nga konsultimi me dokumentat bazë dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se Programi i studimit me karakter profesional 2-vjeçar në Menaxhim, është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar. Ky program është mbështetur në “Planin Strategjik 2021-2025”, Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe përputhet me</p>



drejtimet akademike të tij.	<p>strukturën e ekonomisë shqiptare. Pas përfundimit të këtij programi studentet pajisen me aftësi e kompetenca e aftësi praktike në fushën e menaxhimit të cilët mund të integrohen me shpejtësi dhe efektivitet në sektorët e ndryshëm ekonomik të vendit.</p> <p>Dokumentet rregullatore të UET, përfshirë Rregulloren e Programit të Menaxhimit dhe Statutin e institucionit, tregojnë qartazi se programi është konceptuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet e brendshme. Lëndët janë të organizuara në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, ndërsa përqindjet e krediteve sipas lëndëve bazë, karakterizuese, integruese dhe përmbyllëse respektojnë plotësisht normat ligjore.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Në dosjen e aplikimit është përfshirë “Studimi i tregut të punës” për programin, i cili përshkruan kontekstin ekonomik dhe nevojat për profile menaxheriale në Shqipëri. Ky dokument evidenton kërkesën e lartë për aftësi në menaxhim praktik, marketing, kontabilitet dhe operacione biznesi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UET demonstroi përvojë të konsoliduar dhe kapacitete të mjaftueshme për ofrimin e programit në menaxhim. Për vitin akademik 2024–2025 janë të angazhuar 22 pedagogë, përfshirë 4 me titullin Prof. Dr. dhe disa me gradë Dr./PhD, të cilët mbulojnë të gjitha fushat kyçe të kurrikulës si menaxhim, marketing, kontabilitet dhe financë.</p> <p>Përveç stafit të brendshëm, janë përfshirë edhe pedagogë me eksperiencë nga sektori privat dhe institucione publike, duke garantuar përmbajtje të aplikuar dhe praktike. Lëndët e programit janë të strukturuar sipas kompetencave profesionale të kërkuara nga tregu.</p> <p>Infrastruktura dhe burimet mbështetëse janë adekuate, duke përfshirë hapësira mësimore, bibliotekë dhe akses në burime dixhitale. GVJ vlerëson pozitivisht këto elemente dhe rekomandon vazhdim të investimeve në zhvillimin profesional të stafit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional 2-vjeçar në Menaxhim është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, i cili operon prej vitesh në ofrimin e programeve në menaxhim, biznes dhe ekonomi, në të gjitha ciklet e studimit. Kjo përputhshmëri reflektohet në strukturën e stafit, në lëndët që mbulohen dhe në fushat kërkimore të zhvilluara në nivel</p>

<p>programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>departamenti.</p> <p>Programi është i kodifikuar sipas VKM Nr. 310, datë 11.05.2022, me klasifikimin 52PP, që i përket programeve profesionale me 120 ECTS. Ai është i pozicionuar në fushën ISCED "04 – Biznes, administrim dhe ligj", në përputhje me Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Arsimit dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>GVJ vlerëson se ka një korrespondencë të qartë midis profilit të programit, kapaciteteve akademike të njësisë përgjegjëse dhe standardeve kombëtare e evropiane për klasifikimin e arsimit të lartë.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi përputhet me misionin institucional, objektivat strategjike dhe nevojat e tregut të punës, si dhe reflekton qartë ruajtjen e vlerave kulturore dhe interesave kombëtare.</i></p> <p><i>Struktura e programit është në përputhje me Kornizën Shqiptare dhe Evropiane të Kualifikimeve, dhe është e mbështetur në kapacitete akademike të mjaftueshme, me staf të kualifikuar dhe përvojë të konsiderueshme në fushën e menaxhimit. Gjithashtu, klasifikimi dhe kodifikimi i programit janë në përputhje me VKM Nr. 310/2022 dhe standardet ndërkombëtare (ISCED 2013).</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi I.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UET siguron një bashkëpunim të mirë të brendshëm institucional për menaxhimin efektiv të Programit Profesional në Menaxhim. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, në bashkëpunim me strukturat e tjera mbështetëse si Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, zbatojnë një ndarje të qartë detyrash dhe përgjegjësish për koordinimin e programit dhe praktikave profesionale.</p> <p>Departamenti është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e syllabusit të praktikës, përzgjedhjen e ekspertëve të fushës dhe organizimin e vizitave studimore. Pedagogët këshillues luajnë një rol kyç në ndjekjen dhe vlerësimin e progresit të studentëve</p>



	<p>gjatë praktikës. Gjithashtu, përfshirja e Bordit të Tregut të Punës si organ këshillimor ofron një linjë të drejtpërdrejtë komunikimi midis departamentit dhe aktorëve të tregut të punës.</p> <p>Rregulloret e brendshme dhe dokumentet mbështetëse të praktikës (p.sh., Formulari i Vetvlerësimit dhe Udhëzimet për Praktikën) dëshmojnë një strukturë të mirëorganizuar bashkëpunimi mes aktorëve të brendshëm.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe dhe aktorë të biznesit.</p> <p>UET ka zhvilluar një rrjet të gjerë bashkëpunimesh me institucione vendase dhe të huaja, si dhe me aktorë të biznesit, për të mbështetur objektivat e programit dhe për të mundësuar praktika profesionale e përvoja ndërkombëtare për studentët. Dokumentet tregojnë për ekzistencën e 160 marrëveshjeve në nivel institucional dhe 51 marrëveshjesh në nivel fakulteti, si dhe për pjesëmarrje në programe mobiliteti si Erasmus+, ku janë realizuar 193 mobilitete akademike.</p> <p>Gjithashtu, janë të dokumentuara bashkëpunime me kompani, institucione dhe organizata, që kanë ofruar ambiente për zhvillimin e praktikës profesionale të studentëve të programit.</p> <p><b>Megjithatë, nga takimet e GVJ me studentët e programit, rezultoi se ata nuk ishin të informuar në mënyrë të qartë për mundësitë e pjesëmarrjes në programet e mobilitetit, dhe nuk u raportua ndonjë rast konkret pjesëmarrjeje nga vetë studentët në mobilitete të tilla. Kjo sugjeron nevojën për një strategji më të qartë informimi dhe përfshirjeje të drejtpërdrejtë të studentëve të programeve profesionale në këto mundësi ndërkombëtare.</b></p> <p><b>GVJ rekomandon rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes konkrete të studentëve të programit në nismat ndërkombëtare dhe mobilitetet, për të garantuar ndikim real dhe të barabartë në zhvillimin e kompetencave të tyre.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale,</p>	<p>UET ka vendosur një rrjet të strukturuar marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme të fushës së menaxhimit dhe biznesit, të cilat mbështesin zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të programit.</p> <p>Sipas raportit të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, janë nënshkruar marrëveshje të posaçme, afatgjata dhe të qëndrueshme, që sigurojnë realizimin e praktikës në institucione publike dhe private në nivel vendor dhe kombëtar.</p>

<p>klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>Praktika profesionale është e detyrueshme në strukturën e programit dhe është e shoqëruar me dokumentacion të qartë rregullator, përfshirë udhëzime për organizimin e praktikës, formulare vetëvlerësimi dhe mbikëqyrje nga pedagogë të brendshëm dhe mentorë të jashtëm.</p> <p>UET bashkëpunon aktivisht me subjekte si Intesa Sanpaolo Bank Albania, Deloitte Albania, kompani të nivelit të mesëm dhe institucione të administratës publike, të cilat sigurojnë mjedis praktik profesional për studentët, duke kontribuar në formimin e tyre të drejtpërdrejtë për tregun e punës.</p> <p>Nga takimet e GVJ me stafin dhe dokumentet referuese, u konstatua se procesi i praktikës mbikëqyret në mënyrë të sistematizuar dhe përfshin elementë të vlerësimit të progresit dhe reflektimit nga vetë studentët.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut në UET ka ndërmarrë veprime konkrete për monitorimin dhe vlerësimin e përfitimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e bashkëpunimit me aktorët e jashtëm. Kjo evidentohet në dokumentin “Raporti i Përfitimeve nga Marrëveshjet e Bashkëpunimit”, i cili përmbledh të dhëna analitike mbi numrin e studentëve që kanë realizuar praktikën, fushat ku janë kryer praktikat, dhe ndikimin e bashkëpunimeve në ndihmë të realizimit të objektivave të programit.</p> <p>Raporti trajton gjithashtu pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tregut të punës në bordet këshilluese, panairë të karrierës dhe trajnime të përbashkëta. Ai përmban elementë analitike që identifikojnë institucionet më aktive, fushat që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë dhe vlerësimet mbi përmirësimin e bashkëpunimeve në të ardhmen.</p> <p><b>Megjithatë, GVJ sugjeron që ky raportim të institucionalizohet në mënyrë më sistematike dhe të realizohet në mënyrë periodike (vjetore ose semestrale), si pjesë e mekanizmit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, rekomandohet përfshirja më e qartë e matësve të performancës, si punësueshmëria pas praktikës apo feedback nga institucionet pritëse.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>UET ka ndërmarrë një sërë nismash specifike për të mbështetur punësimin dhe zhvillimin e kompetencave sipërmarrëse të studentëve, në përputhje me misionin e tij për të formuar profesionistë të orientuar drejt tregut të punës dhe krijimit të vlerës.</p>

	<p>Përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, janë organizuar aktivitete të rregullta si: Panairi i Punës, javët e karrierës, sesione informuese për sipërmarrjen, trajnime për zhvillim personal dhe profesional, si dhe workshop-e me përfaqësues të biznesit.</p> <p>Gjithashtu, UET ka ndërtuar një rrjet të strukturuar me kompani partnere, të cilat shërbejnë jo vetëm për praktikatat profesionale, por edhe për përfshirjen e studentëve në projekte reale dhe mundësi punësimi të hershëm. Këto nisma kanë ndihmuar në krijimin e urave të forta ndërmjet universitetit dhe tregut të punës.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson se UET ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi funksionale, brenda dhe jashtë institucionit, që mbështesin zbatimin e programit profesional në Menaxhim. Janë të pranishme marrëveshje me institucione dhe kompani për zhvillimin e praktikave, si dhe nisma për aftësimin dhe punësimin e studentëve.</i></p> <p><i>Megjithatë, studentët e programit nuk janë të informuar mirë mbi mundësitë e mobilitetit ndërkombëtar, dhe nuk u identifikuan raste konkrete pjesëmarrjeje. Raportimi mbi përfitimet nga bashkëpunimet ekziston, por kërkon më shumë rregullsi dhe integrim në procesin e sigurimit të cilësisë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UET ka hartuar dhe miratuar një Strategji për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (2023–2028), në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, Kodin e Cilësisë dhe standardet ESG 2015 të Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Strategjia përcakton politika, objektiva, strukturat dhe procedurat për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike, administrative dhe kërkimore. Kjo strategji është miratuar me Vendim të Senatit Nr. 15, datë 23/12/2022 dhe përfshin komponentë si: sistemin e vlerësimit të silabuseve, mekanizmat e ankesave, dhe formatet e vlerësimit të stafit akademik nga

	<p>studentët.</p> <p>Institucioni ka aktivizuar Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) dhe përdor mjete konkrete si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Formularë për vlerësimin e pedagogëve nga studentët,</li> <li>• Formularë për ankesat dhe propozimet e studentëve,</li> <li>• Matricën e përputhshmërisë së silabuseve dhe raporte monitorimi periodike për programet.</li> </ul> <p>Gjithashtu, UET është angazhuar në projekte ndërkombëtare si Bologna Hub Peer Support, duke përfutur nga konsulencia ekspertësh europianë për zbatimin e reformave cilësore në mësimdhënie dhe tërësinë e programit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UET ka ngritur dhe mban funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në përputhje me strategjinë institucionale 2023–2028. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) është aktiv dhe ka një rol të qartë në mbledhjen, analizimin dhe adresimin e të dhënave të cilësisë. Aktivitetet e tij përfshijnë monitorimin e silabuseve, raportimin mbi ecurinë e mësimdhënies dhe përgatitjen e raporteve për organet drejtuese.</p> <p>Studentët janë përfshirë si pjesë e mekanizmave të sigurimit të cilësisë, si në vlerësimin e pedagogëve, ashtu edhe përmes formave të mbledhjes së ankesave dhe sugjerimeve. Gjithashtu, përfshirja e ekspertëve të jashtëm është realizuar si pjesë e projekteve ndërkombëtare si Bologna Hub Peer Support, ku u përfutuan rekomandime konkrete nga vlerësues të huaj për përmirësimin e kurrikulës dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p>Procesi i rishikimit të programit profesional në Menaxhim është shoqëruar me analiza të brendshme dhe kontribut nga bashkëpunëtorë të jashtëm, si përfaqësues të tregut të punës dhe alumni, të cilët janë përfshirë në strukturat këshilluese si Bordi i Tregut të Punës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e</p>	<p>UET përdor një sërë instrumentesh të dokumentuar dhe të zbatuar në praktikë për të garantuar cilësinë e brendshme të programeve të studimit. Këto përfshijnë:</p> <p>Vlerësimin nga studentët të stafit akademik, nëpërmjet formularëve të standardizuar që analizohen në mënyrë periodike nga KSBC;</p> <p>Mekanizmat për mbledhjen e ankesave, sugjerimeve dhe feedback-ut nga studentët dhe aktorët e tjerë institucionale;</p> <p>Raporte të rregullta të monitorimit të silabuseve dhe përputhshmërisë me standardet akademike, të cilat ndihmojnë në</p>

<p>përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>rishikimin e përmbajtjes së programeve dhe përmirësimin e praktikave mësimore.</p> <p>Përveç instrumenteve të brendshëm, institucioni i nënshtrohet edhe procesit të akreditimit nga ASCAL, si dhe ka përfituar nga vlerësimi ndërkombëtar në kuadër të projekteve si Bologna Hub Peer Support, që kanë përfshirë krahasime me praktikat europiane dhe kanë nxjerrë rekomandime për përmirësim.</p> <p>Gjithashtu, janë evidentuar praktika krahasuese dhe analiza të brendshme të cilat ndihmojnë në reflektimin dhe përshtatjen e objektivave të programeve me zhvillimet në arsimin e lartë dhe tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>UET aplikon tregues të qartë dhe të matshëm për monitorimin e cilësisë në mësimdhënie dhe aktivitete kërkimore, të cilët janë të parashikuara në Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2023–2028 dhe në aktet rregullatore institucionale. Këta tregues përfshijnë: nivelin e vlerësimit të pedagogëve nga studentët, përqindjen e përmbushjes së objektivave të kurrikulës, përfshirjen e stafit në trajnime dhe projekte kërkimore, dhe pjesëmarrjen në konferenca apo publikime akademike.</p> <p>Monitorimi i performancës në mësimdhënie kryhet në mënyrë periodike dhe përfshin edhe komponentin e feedback-ut nga studentët, i cili përdoret si bazë për përmirësime në përmbajtje dhe metoda mësimore. Njësitë përgjegjëse si Departamenti i Menaxhimit dhe KSBC përpilojnë raporte vjetore mbi përmbushjen e këtyre treguesve dhe propozojnë masa për përmirësim.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka struktura për promovimin e arritjeve cilësore, si: nxitje për angazhim kërkimor, mbështetje për pjesëmarrje në trajnime dhe konferenca, si dhe sistem shpërblyerës për kontribute akademike.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se UET ka ndërtuar dhe zbaton një sistem të mirëstrukturuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet kombëtare e ndërkombëtare. Strategjia institucionale për cilësinë është aktive dhe e dokumentuar, ndërsa KSBC funksionon si një strukturë koordinuese për zbatimin dhe monitorimin e këtij sistemi.</i></p> <p><i>Përdorimi i instrumenteve të vlerësimit, matricave të përputhshmërisë së kurrikulës, formularëve të vlerësimit dhe ankesave, si dhe përfshirja e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm në procese të vlerësimit, dëshmojnë për një kulturë institucionale të konsoliduar të cilësisë.</i></p>

	<p><i>Gjithashtu, përdorimi i treguesve të matshëm për performancën në mësimdhënie dhe kërkim, dhe mekanizmat promovues për arritjet cilësore, mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm dhe motivimin e stafit.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon vijimësinë dhe përmirësimin e integritetit të të dhënave cilësore në vendimmarrje dhe transparencën e raporteve për të gjithë aktorët.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit me karakter profesional 2-vjeçar në Menaxhim është i organizuar në lëndë dhe module në përputhje me legjislacionin vendas si dhe Sistemin Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si <i>Kurrikula e programit diplomë Profesionale në Menaxhim, Plani mësimor dhe Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese</i> rezulton se programi i studimit është organizuar në lëndë dhe module duke respektuar shpërndarjen e krediteve sipas standartit të Vendimit Nr. 185, datë 25.3.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr 41, datë 24.01.2018, “Për elemente të programeve të studimit të ofruara nga institucione të arsimit të lartë”, të ndryshuar.</p> <p>Programi ka 120 kredite (ECTS), ku secila prej lëndëve përbërëse të tij ka nga 6 kredite, praktika 6 kredite, provimi i formimit i konceptuar si projekt profesional në respekt të përpmbujlljes së studimeve me 5 kredite.</p> <p>Organizimi i lëndëve sipas kërkesave ligjore respekton kategorizimet lëndë bazë 15%, lëndë karakterizuese 53%, lëndë</p>

	integeruese 15%, lëndë plotësuese D 12,5% dhe detyrimet përmbyllëse 4,1%
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.	<p>Programi i studimit profesional në Menaxhim përmes Strategjisë së zhvillimit të tij garanton pajisjen e studentëve me njohuritë bazë formuese të domosdoshme në fushën komplekse të menaxhimit referuar problemeve të planifikimit, organizimit, menaxhimit të burimeve njerëzore, drejtimit dhe kontrollit, me objektiv kryesor formimin e specialistëve për zgjidhjen praktike të problemeve menaxheriale të kombinuara.</p> <p><b>Panvarësisht kësaj vihet re se strategjia që përcakton shtyllat kryesore të orientimit të programit në disa raste kapërcen nivelin e njohurive që i përshtaten këtij programi studimi për kornizën e studimit së cilës ajo i përket. Kjo vihet re në disa raste në kërkesa për zhvillim të kompetencave në menaxhim strategjik apo analiza komplekse financiare dhe menaxheriale.</b></p>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	<p>Programi i studimit profesional në Menaxhim ka të përcaktuar në dy dokumenta si rregullorja e Studimit dhe Plani Strategjik objektiva si Objektivat e Programit të Studimit si: <i>Krijimi i njohurive dhe koncepteve bazë të fushës së studimit, Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale, Formim qytetar të përgjithshëm, Aftësi bazë për punë kërkimore aplikative, Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative, Aftësim për promovim personal, Projekt profesional pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon aftësitë e tij brenda profesionit të zgjedhur.</i></p> <p><b>Nga ana tjetër përcaktimi i objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm duket se përfaqëson një grup objektivash shumë më ambicioz se kërkesat e programit, si psh “Analiza dhe vlerësimi i performancës së biznesit”</b> Nga raporti konstatohet një mungesë rakordimi midis raportimit të GVB dhe informacionit që vetë raporti i tyre referon përmes referencave të vëna në dispozicion duke mos përmendur drejt objektivat që programi ka konceptuar dhe që janë pasqyruar në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim, Pika II: Objektivat e Programit të Studimit dhe Rregullore e Programit të studimit, Pika 3,3: Objektivat a-g.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke	Mbështetur në raportimin e dokumenteve të konsultuara, programi i studimit ka të strukturuar planin e ngarkesës mësimorë në kredite për të gjitha lëndët. Informacioni është i detajuar në kategorizim të lëndëve, ngarkesa në kredite sipas

<p>përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>veprimtarive mësimorë, ngarkesë mësimorë në orë fizike në auditor, orë studimi individuale dhe orë totale. Nisur nga natyra e programit është e përcaktuar po ashtu edhe realizimi i praktikës profesionale e cila nga një kombinim midis praktikës në auditor dhe në mjediset e biznesit është ndryshuar për vitin 2024-2025, duke e përcaktuar me vendim ndjekjen e saj në ambjentet e institucionit.</p> <p>Detyrimet përbyllëse synojnë të realizohen përmes një projekti profesional me karakter praktik në lidhje me një tematikë të caktuar, apo një rast studimor.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Për këtë program studimi dhe Institucioni: Universiteti Europian i Tiranës nuk aplikohet</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit profesional në Menaxhim respekton Ligjin 80/2015, neni 86, pika 6 mbi Kodifikimin e programeve të studimit, duke ndjekur procedurat për kodifikimin dhe miratimin e tij nga Ministria e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Nga ky proces ka rezultuar kodifikimi i fushës së studimit në Menaxhim. Nga raporti i vlerësimit të brendshëm rezultons e programi profesional në Menaxhim mbështetet në programe të ngjashme të institucioneve të ngjashme</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar kodin përkatës duke respektuar fushën e studimit dhe duke ndjekur klasifikimet e bëra publike nga Ministria e Arsimit. Përmbajtja e programit ka përcaktuar kodin mbështetur në përmbajtjen e kurrikulës dhe rezultatet e pritshme.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Strategjia që përcakton shtyllat kryesore të orientimit të programit në disa raste kapërcen nivelin e njohurive që i përshtaten këtij programi studimi për kornizën e studimit së cilës ajo i përket. Kjo vihet re në disa raste në kërkesa për zhvillim të kompetencave në menaxhim strategjik apo analiza komplekse financiare dhe menaxheriale.</i></p>

	<i>Gjithashtu, përcaktimi i objektivave në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm duket se përfaqëson një grup objektivash shumë më ambicioz se kërkesat e programit, si psh "Analiza dhe vlerësimi i performancës së biznesit".</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Programi i studimit, Diplomë profesionale ne Menaxhim realizohet në Fakultetin e Eknomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Njësia bazë përgjegjëse për kordinomon e punës në lidhje me realizimin e objektivave të institucionit dhe vetë programit është Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut. Nga pikëpamja ligjore njësia kryesore në këtë rast fakulteti përmbush kriteret për zhvillimin e kësaj diplome. Ajo përbëhet nga departamenti i Menaxhimit dhe Marketungut, Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm.</p> <p>Po ashtu nga pikëpamja e stafit të angazhuar në këtë program kemi përputhje me përcaktime ligjore sa i takon numrit të anëtarëve dhe ngarkesës mësimore të përcaktuar. Departamenti angazhon po ashtu staf akademik me kontratë duke respektuar procedurat e përcaktuara në rregullore dhe statut. Numri i stafit akademik është</p> <p>2022-2023 8 PAE/10 PAK 2023-2024 10 PAE/8 PAK 2024-2025 7 PAE/9 PAK</p> <p>Përbërja është</p> <p>7 PAE 1 Prof. Dr, 1 Prof As, 4 Dr ,1 Phd 9 PAK 1 Prof Dr, 2 Prof As , 3 Dr, 3 Msc</p> <p>Stafi akademik plotëson po ashtu kriteret për kapacitet profesionale duke konsideruar edhe respektimin e mësimdhënies sipas nivelit të programit.</p> <p>Po ashtu është respektuar ngarkesa mësimore si edhe raportet e përcaktuara nga Vendim nr. 879, datë 18.12.2019, Për disa</p>

	ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”			
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Raporti i Vlerësimit të Brendshëm nuk jep referencën e duhur për kriterin, pasi nuk ka të dhëna mbi angazhimin e personelit ndihmës akademik/ administrativ për realizimin e praktikave mesimore, laboratorike ose klinike për programin e studimit Diplomë profesionale në Menaxhim. Vetëm numri i stafit administrativ jepet në nivel institucioni në Tabelën 8, dokumenti 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB programi DPM.pdf, pa evidentuar numrin e personelit ndihmës akademik /administrativ që i përket specifikisht njësisë kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit. Informacioni në Tabelën Nr. 8 si dokument referues përfshin informacionin rreth numrit të stafit në nivel institucioni pa sjellë fakte të tjera sesi ky staf i dedikohet programit dhe sesi formimi i tij është ose jo në përputhje me nevojat e programit..			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia kryesore si Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit si edhe njësia bazë përgjegjëse si Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut kanë përcaktuar sipas procedurave të parashikuara në kuadrin ligjor kordinatorin e programit Diplomë Profesionale në Menaxhim. Rregullorja e studimit e parashikon rolin e kordinorit të programeve si pjese e detyrës së përgjegjesit të grupeve mësimore kërkimore duke marrë përgjegjësinë e koordinorit të programeve të studimit të ofruara nga Departamenti në nënfushën përkatëse më afër ekspertizës së grupit mësimor, përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e kurrikulës së programit/eve përkatëse, për të garantuar respektimin e parimeve dhe kritereve të përcaktuara në aktet rregullatore të miratuara, dhe për të siguruar përditësimin e tyre me të rejat e shkencave përkatëse dhe kërkesat e tregut të punës.			
<b>Konkluzione</b>	Numri i stafit administrativ jepet në nivel institucioni, pa evidentuar numrin e personelit ndihmës akademik /administrativ që i përket specifikisht njësisë kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit: Diplomë Profesionale në Menaxhim, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion ruhet në një folder të aksesueshëm për të gjithë anëtarët e stafit akademik në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Po ashtu të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve janë të përcaktuar në statute dhe rregullore. Po ashtu edhe për studentët ekziston aksesimi për të konsultuar informacionet e nevojshme. Në funksion të transparencës dhe komunikimit institucioni operon edhe përmes platformës LMS dhe faqen zyrtare të Universitetit Europian të Tiranës.</p> <p>Nga takimi në mjediset e institucionit po ashtu vihet re se stafi dhe studentët zotërojnë mundësinë përmes formave të ndryshme të sigurimit të informacionit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit përmban planin mësimor, i cili pasqyron informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve, numrin e krditeve për secilën lëndë dhe orët në auditor. Po ashtu në rregulloren e njësisë bazë përcaktohet elementët e përmbatjes së programit, mnëyrën e organizmit, përgjegjësitë dhe detyrimet.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Rregullorja e studimit përcakton kushtet e pranimit, dokumentacionit të nevojshëm, kriteret e pranimit, procedurat që duhet të ndiqen nga kandidatët dhe aspektet financiare dhe administrative duke ofruar transparencë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të</p>	<p>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit. Informacioni sipas kërkesave ligjore në fuqi reflektohet në syllabusin e secilës lëndë duke kaluar procedurat miratimit nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><b>Pavarësisht kësaj syllabuset e lëndëve duhet të plotësohen në secilin rast me informacionin e plotë në lidhje me ndarjen e</b></p>

<p>programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>orev, pasi ka syllabuse ku informacioni në lidhje me orët e mësimit nuk reflekton atë të planit të ngarkesës së programit. Në shumicën e rasteve janë të shënuara orë leksione dhe auditori pa përfshirë orët e planifikuara si praktika në auditor</p> <p>Po ashtu duhet specifikuar edhe tipologjia e lëndës e cila edhe pse ekziston në kurrikulën e programit duhet të pasqyrohen edhe në syllabusin e lëndës në program për të respektuar plotësisht kërkesat ligjore të formatit të përcaktuar të syllabusit.</p> <p>Gjithashtu, vihet re se syllabuset e programit janë pjesë edhe e programeve të tjera të studimit në Universitetin Europian të Tiranës duke e bërë të pamundur evidentimin e plotë të kategorisë së lëndës për programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim. Në këtë mënyrë është e pamundur për të gjykuar edhe mbi sigurimin e raportit të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50/50). Qoftë nga vizita në institucion respektivisht në takimet me stafin akademik dhe studentët rezultojnë se elementët e ndërtimit të syllabuseve si dhe realizimi praktik i këtyre elementëve, janë ndërtuar dhe janë aplikuar për dy cikle studimi njëkohësisht si bachelor dhe program profesional dhe disa programe studimi, duke cënuar qëllimin dhe objektivat e programit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Në përputhje edhe me rekomandimet e dhëna për ecurinë e programit, përmbajtja e programit të studimit, Diplomë Profesionale në Menaxhim është në përmirësim. Disa nga ndryshimet janë reflektuar veçanërisht në numrin e krediteve dhe strukturën e ngarkesës së praktikës dhe teorisë. <b>Megjithatë përmbajtja e syllabuseve shpesh kapërcen kompetencat e parashikuara për këtë program studimit me karakter profesional.</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Syllabuset e lëndëve duhet të plotësohen në secilin rast me informacionin e plotë në lidhje me ndarjen e oreve, pasi ka syllabuse ku informacioni në lidhje me orët e mësimit nuk reflekton atë të planit të ngarkesës së programit. Në shumicën e rasteve janë të shënuara orë leksione dhe auditori pa përfshirë orët e planifikuara si praktika në auditor.</i></p> <p><i>Duhet specifikuar edhe tipologjia e lëndës e cila edhe pse ekziston në kurrikulën e programit duhet të pasqyrohen edhe në syllabusin e lëndës në program për të respektuar plotësisht kërkesat ligjore të formatit të përcaktuar të syllabusit.</i></p>

	<p>Syllabuset e programit janë pjesë edhe e programeve të tjera të studimit në Universitetin European të Tiranës duke e bërë të pamundur evidentimin e plotë të kategorisë së lëndës për programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim. Në këtë mënyrë është e pamundur për të gjykuar edhe mbi sigurimin e raportit të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50/50).</p> <p>Përmbatja e syllabuseve shpesh kapërcen kompetencat e parashikuara për këtë program studimit me karakter profesional.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.4	
<p><b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim përmban emërtim, përmbajtja të veprimtarive, shpërndarje të lëndëve dhe praktikave që mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve Struktura e tyre krijon mundësi për plotësimin e njohurive të nevojshme për një profesionist në fushën e menaxhimit</p> <p><b>Pavarësisht kësaj ngarkesa e tyre sipas syllabuseve duket se nuk ka ndryshim nga ngarkesa e syllabuseve në ciklet bachelor. Ky konstatim përbën një ngarkesë më të lartë për profilizimin e studentit në studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim duke sjellë ngarkesë dhe për shkallën e formimit të tij.</b></p> <p>Qëllimi është që njohuritë e ofruara në lëndët e programit t'i mundësojnë studentit adaptim shumë më të lehtë në praktikë pa kërkesa ambicioze për kërkim të mirëfilltë shkencor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe</p>	<p>Programi i studimit Diplomë profesionale në Menaxhim ofron lëndë me shpërndarje në vite e semestra, vlerësim në kredite e orë mësimore që mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. Sipas Kurrikulës mësimore lëndët bazë zënë 18 kredite, lëndët karakterizuese 64, lëndët ndërdisiplinore 18, lëndët integruese</p>

rezultateve të pritshme të të nxënit.	15, detyrimet përmbyllëse 5, me një total prej 120 kreditesh <i>Kurrikula e programit DPM (shqip).</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<p>Programi i studimit përbëhet nga lëndë që ofrojnë informacion të rëndësishëm në formimin e njohurive menaxheriale. Nga përbërja e lëndëve duket se ato ofrojnë një raport të balancuar midis njohurive teorike dhe praktike (psh., 28 orë leksione, 14 orë seminare, 14 – 20 orë Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor) <i>14.2 Plani mësimor i programit (shqip).pdf.</i> <b>Ndërkohë në Syllabus kjo ndarje nuk pasqyrohet, megjithse do duhet të reflektohet e njëjta ndarje e orëve mësimore. 19.1. SYLLABUSET SHQIP.pdf.</b></p> <p><b>Po ashtu, ky konstatim konfirmohet edhe nga vizita në institucion, ku nga takimet e ndryshme rezultoi se Syllabuset e lëndëve të programit të studimit Diplomë profesionale në Menaxhim, janë të njëjta me Syllabuset e lëndëve të programeve të studimeve Bachelor.</b></p> <p>Gjithashtu, orët mësimore që reflektojnë formën të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor) <i>14.2 Plani mësimor i programit (shqip).pdf., nuk pasqyrohen në ngarkesën totale të personelit akademik të programit Diplomë Profesionale në Menaxhim për vitin akademik 2024-2025. (0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB programi DPM.pdf., Tabela 4. Ngarkesa totale sipas viteve akademike, Tabela 4.1 Ngarkesa totale v.a. 2024-2025).</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Sipas Planit mësimor të programit (<i>14.2 Plani mësimor i programit (shqip).pdf</i>), ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues pasi rezulton se programi ofron 309 orë nga 1246 orë si formë kontrolli i vazhdueshëm ose aftësim praktik që përbën 25% të totalit të orëve për 2 vjet. Balancimi i moduleve në bazë, karakterizuese, integruese, plotësuese mundësojnë ofrimin e njohurive të plota formuese. Po ashtu emërtimi i lëndëve mundëson transferim të studimeve në programe duke rritur fleksibilitetin dhe adaptimin e studentit. Veprimtaritë formuese janë ndërtuar që të mundësojnë dhe ndihmojnë punësimin e studentëve në përfundim të studimeve. <b>Por, sa u tha në Kriterin 3, Standarti II.4, nuk dëshmohet realizimi praktikisht i të gjithë elementëve të programit të studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim.</b></p>
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve	Syllabuset, në përgjithësi, nga pikëpamja formale janë të ndërtuara në përputhje me kërkesat ligjore të VKM 41,

<p>/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p><b>megjithatë është e nevojshme të të vendoset kategorizimi i lëndës i cili tregohet vetëm në kurrikulën e programit.</b></p> <p>Sa i takon <b>tematikave dhe çështjeve që trajtohen, ka nevojë për fokusim në përputhje me zhvillimin e aftësive specifike pasi disa prej tyre marrin një karakter më të gjerë duke u ndalur në shumë trajtime të hollësishme teorike, jo plotësisht të përshtatshme për kuadrin e programit të studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim.</b></p> <p><b>Në disa syllabuse, literatura është mjaft më e thelluara sesa kërkesat e programit të studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim, kjo edhe sepse syllabusi nuk ka një ndarje midis atij profesional dhe bachelor.</b></p> <p>Sa i takon përditësimin, ka përmirësime në lidhje me përmbajtjen, por kjo është realizuar në përgjithësi, pa i dedikuar një profilizim vetë natyrës së programit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Programi i studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim siguron një bashkëpunim midis institucionit dhe punëdhënësve. Praktika profesionale është lëndë e detyrueshme për këtë program me qëllim dhënien e mundësisë studentit të zbatojë në praktikë njohuritë teorike që ka marrë në auditor. Në kurrikul është përcaktuar vlerësimi i praktikës me 6 kredite me një detyrim prej 150 orësh punë për studentin duke konceptuar edhe një përgatitje në auditor për ambjentimin me mjedisin e praktikës profesionale. <i>(14.2 Plani mësimor i programit (shqip).pdf; 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim garanton përftimin e dijeve aftësive, por vihet re një <b>kapërcim i tyre sa i takon përputhshmërisë me nivelin 5 të KSHK.</b> Për rrjedhim edhe kompetencat e synuara duket se janë më sfiduese nga pritshmëritë e programit. Kjo mund të krijojë një hendek midis aplikimit dhe ecurisë së studentëve në program. <i>(14. Kurrikula e programit DPM (shqip).pdf; 19.1. SYLLABUSET SHQIP.pdf)</i> Ndërtimi i syllabuseve duhet të respektojë natyrën, elementët, objektivat dhe rezultatet e pritura për një nivel studimi që i përket Kornizës 5 të Kritereve Shtetërore të Kualifikimit (KShK). Në të kundërt kërkesat ligjore nuk do të diferencenin programet e studimit në nivele me objektiva, qëllime dhe kritere të mirëpërcaktuara për të siguruar garantimin e përftimit të njohurive në përputhje me to.</p>
	<p><b>Po ashtu, nga takimet, rezultojnë konkretisht se mësimi realizohet së bashku me studentët e ciklit bachelor duke cenuar përftimin e plotë të njohurive apo cilësinë e tyre për</b></p>

	<b>secilin program.</b>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Në programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim ngarkesa e lëndëve sipas syllabuseve duket se nuk ka ndryshim nga ngarkesa e syllabuseve ne ciklet bachelor. Ky konstatim sjell një ngarkesë më të lartë për profilizimin e studentit në këtë program.</i></p> <p><i>Sa i takon tematikave dhe çështjeve që trajtohen, ka nevojë për fokusim në përputhje me zhvillimin e aftësive specifike, pasi disa prej tyre marrin një karakter më të gjerë duke u ndalur në shumë trajtime të hollësishme teorike, jo plotësisht të përshtatshme për kuadrin e programit të studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim.</i></p> <p><i>Në disa syllabuse, literatura është mjaft më e thelluara sesa kërkesat e programit të studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim, kjo edhe sepse syllabusi nuk ka një ndarje midis atij profesional dhe bachelor.</i></p> <p><i>Përbërja e lëndëve ofron një raport të balancuar midis njohurive teorike dhe praktike, por në Syllabus kjo ndarje mungon, megjithse do duhet të reflektonte të njëjtën ndarje e orëve mësimore. Po ashtu, ky konstatim konfirmohet edhe nga vizita në institucion.</i></p> <p><i>Gjithashtu, orët mësimore që reflektojnë formën të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor) nuk pasqyrohen në ngarkesën totale të personelit akademik të programit Diplomë Profesionale në Menaxhim për vitin akademik 2024-2025.</i></p> <p><i>Syllabuset, në përgjithësi, nga pikëpamja formale janë të ndërtuara në përputhje me kërkesat ligjore të VKM 41, megjithatë është e nevojshme të të vendoset kategorizimi i lëndës i cili tregohet vetëm në kurrikulën e programit.</i></p> <p><i>Përmbajtja e programit të studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim garanton përfitim të dijeve aftësive, por vihet re një kapërcim i tyre sa i takon përputhshmërisë me nivelin 5 të KSHK. Për rrjedhim edhe kompetencat e synuara duket se janë më sfiduese nga pritshmëritë e programit. Kjo mund të krijojë një hendek midis aplikimit dhe ecurisë së studentëve në program.</i></p> <p><i>Po ashtu, nga takimet, rezulton se konkretisht mësimi realizohet së bashku me studentët e ciklit bachelor duke cenuar përfitim të plotë të njohurive apo cilësinë e tyre për secilin program.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

**Standardi II.5**

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Njësia bazë përgjegjëse për Diplomën Profesionale në Menaxhim është angazhuar në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, Kjo gjë është arritur përgjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit. Departamenti është konsultuar dhe ka marrë në konsideratë opinonet dhe propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. Ajo ka realizuar takime me përfaqësues të Bordit të Punës për të vjelur opinonet e tyre në lidhje me programin por edhe me përmirësimin e tij duke përfshirë koncepte të ndryshme, teknika apo qasje pro tregut të punës ( <i>12.2. Minutat e takimit BTP.pdf</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit.	Institucioni ka respektuar përfqësimit studentëve në strukturat vendimarrëse, ka krijuar mundësinë për të nxitur diskutimet me studentët. <b>Megjithatë interesi dhe përfshirja e tyre është e ulët edhe për shkak të mungesës së interesit dhe dinamikave të tjera të aktivitetit.</b> Strukturat argumentojnë për organizimin e takimeve të përmuajshme me studentët për të reflektuar mendimin dhe shqetësimet e tyre.
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.	Programi i studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim ka në objektivat e veta përmirësimin e programit, <b>por ndërsa konceptimi i syllabusit është bërë të përfaqësojë konceptet, njohuritë, objektivat së bashku me programet bachelor, krijon një pengesë për përmirësime apo përshtatje të programit të studimit në fjalë.</b>
<b>Konkluzione</b>	<i>Njësia bazë përgjegjëse për Diplomën Profesionale në Menaxhim është angazhuar në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit, por kjo nuk reflektohet në dokumentacion</i>

	<i>(Syllabus) pasi konceptet, njohuritë, objektivat trajtohen së bashku me programet bachelor duke krijuar pengesë për përmirësimin, përditësimin, përshtatjen e programin të studimit në fjalë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi profesional 2-vjeçar në Menaxhim në UET përfshin një shumëllojshmëri formash të mësimdhënies, si leksione, seminare, detyra praktike, projekte, punë kursi dhe praktika profesionale. Këto janë të dokumentuara në silabuset e lëndëve dhe të kontrolluara në mënyrë periodike nga KSBC për përputhshmëri me standardet institucionale.  Pavarësisht kësaj zhvillimi i mësimin bashkërisht me studentët e programit bachelor veçanërisht për orët e leksioneve çënon formimin e studentit të programit. Edhe pse argumentimi se orët e seminareve zhvillohen në mënyrë të diferencuar, nuk justifikon kërkesën për organizim të mësimin sipas kriterëve të përcaktuara. Marrja e njohurive në orët e leksionit duke ndjekur këtë logjikë do të çënojë ose programin e Diplomës Profesionale ose atë të Programit Bachelor.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të	UET ka ndërtuar një trupë akademike me eksperiencë në fushën e menaxhimit dhe përgatitjen profesionale, e mbështetur nga personel ndihmës akademik dhe struktura mbështetëse, si Zyra e Karrierës dhe Sekretaria Mësimore. Këto struktura mundësojnë

<p>studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>mbështetje të vazhdueshme akademike dhe administrative për studentët.</p> <p>Në dokumentet e vlerësimit të silabuseve dhe në metodologjinë e punës së KSBC, vihet re angazhimi për përdorimin e metodave të ndryshme mësimore, përfshirë: mësimin në grup, projektet praktike, detyrat e pavarura dhe kontaktin e drejtpërdrejtë me pedagogun. Përveç kësaj, stafi është përfshirë në trajnime të vazhdueshme për zhvillimin profesional dhe për përmirësimin e metodave të mësimdhënies.</p> <p><b>Megjithatë, nga takimet me studentët u vu re se, pavarësisht përpjekjeve institucionale, nuk evidentohet ndonjë përdorim i qartë i metodave të personalizuara që u përgjigjen larmisë së studentëve në këtë program. Mësimi i përbashkët me studentët e ciklit bachelor redukton fleksibilitetin dhe adaptimin ndaj nevojave të specifike të studentëve të programit profesional.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>UET demonstroi angazhim për përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencave didaktike dhe pedagogjike të personelit akademik përmes organizimit të trajnimeve periodike, seminareve ndër-institucionale dhe nismave të zhvillimit profesional. Këto përfshijnë tematika që lidhen me përdorimin e metodave aktive të mësimdhënies, integrimin e teknologjisë në mësim, vlerësimin kompetencë-bazuar dhe qasjen me në qendër studentin.</p> <p>Gjithashtu, përmes KSBC dhe strukturave të sigurimit të cilësisë, realizohet monitorimi dhe analizimi i praktikave të mësimdhënies, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të qasjeve pedagogjike dhe përputhshmërisë me rezultatet e të nxënit. Vlerësimi i pedagogëve nga studentët dhe raportet e monitorimit shërbejnë si bazë për përcaktimin e nevojave për zhvillim profesional dhe për përmirësime të synuara në përmbajtje dhe metodologji.</p> <p><b>Megjithëse evidencat tregojnë për ekzistencën e këtyre mekanizmave, nga takimet me studentët nuk u identifikuan shembuj konkretë të reflektimit të këtyre trajnimeve në përvojën e tyre të drejtpërdrejtë mësimore, çka nënkupton nevojën për një lidhje më të drejtpërdrejtë ndërmjet zhvillimit të stafit dhe përmirësimit të praktikave në klasë.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të</p>	<p>Stafi akademik i përfshirë në programin profesional zotëron kualifikimet përkatëse dhe eksperiencë të konsiderueshme në fushën e menaxhimit, siç dëshmohet nga CV-të dhe të dhënat mbi aktivitetin e tyre akademik e profesional. Silabuset dhe dokumentet mbështetëse tregojnë për përdorimin e metodave</p>

<p>ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>interaktive të mësimdhënies dhe përfshirjen e elementëve të punës praktike, studimeve të rasteve dhe projekteve në grup.</p> <p>Gjithashtu, janë krijuar kushte për ndërveprim të rregullt midis stafit dhe studentëve, përmes konsultimeve të rregullta dhe mbështetjes akademike individuale. Kjo mbështetet edhe nga roli i njësive si Zyra e Karrierës dhe Sekretaria Mësimore, që ndihmojnë në ndërtimin e një klime respekti dhe komunikimi efektiv.</p> <p><b>Megjithatë, nga takimet me studentët, GVJ evidentoi disa kufizime në zbatimin praktik të metodave me në qendër studentin.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut dhe KSBC në UET aplikojnë proces të rregullt vlerësimi të silabuseve dhe metodave të mësimdhënies, bazuar në një metodologji të miratuar, që përfshin mbledhjen e të dhënave nga studentët përmes formateve të vlerësimit të pedagogëve dhe raporteve të fokus-grupeve.</p> <p>Studentët marrin pjesë në vlerësimin e përvojës së tyre akademike përmes pyetësorëve periodikë dhe mekanizmave të feedback-ut, si dhe në grupe diskutimi të organizuara nga strukturat përkatëse. KSBC analizon këto të dhëna dhe i paraqet në raporte që ndihmojnë në identifikimin e fushave për përmirësim.</p> <p><b>Megjithatë, nga analiza e feedback-ut të studentëve dhe nga takimet e GVJ, u konstatua se disa prej rekomandimeve të studentëve, si ndarja e orëve mësimore nga bachelor apo lehtësimi i ngarkesës, nuk janë reflektuar ende në mënyrë të plotë në praktikat mësimore. Kjo sugjeron se, ndonëse procesi ekziston, ndikimi konkret në përmirësim mbetet i pjesshëm.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe</p>	<p>UET ka ngritur struktura të mirëpërcaktuara për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, si Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) dhe njësitë akademike përgjegjëse për programin. Këto struktura funksionojnë në koordinim për të zbatuar politikat e zhvillimit të cilësisë, monitorimin e zbatimit të silabuseve dhe analizimin e përvojave mësimore.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka promovuar trajnime të specializuara për personelin akademik dhe ndihmës akademik që synojnë përmirësimin e aftësive pedagogjike dhe eksperimentimin me metoda të reja të mësimdhënies, si përdorimi i teknologjisë digjitale, qasja kompetencë-bazuar dhe mësimi përmes projektit.</p>

<p>zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në kuadër të kësaj nisme, UET ka marrë pjesë edhe në projekte ndërkombëtare si Bologna Hub Peer Support, ku janë marrë rekomandime për zhvillimin e metodave inovative dhe integrimin më të thellë të metodave aktive në mësimdhënie.</p> <p><b>Megjithëse proceset janë të dokumentuara dhe trajnimet të rregullta, nga vlerësimi i GVJ rezulton se eksperimentimi me forma të reja të mësimdhënies nuk është ende i institucionalizuar në nivel programi dhe nuk evidentohet qartësisht në përvojën konkrete të studentëve të programit profesional, sidomos përsa i përket diferencimit nga programet e tjera të cikleve më të gjata.</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se programi profesional 2-vjeçar në Menaxhim i UET ofron një strukturë të ndërtuar mbi një gamë të gjerë metodash mësimore dhe angazhim për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Dokumentacioni mbështetës dhe aktivitetet e zhvilluara tregojnë se ekziston një sistem funksional për planifikimin, monitorimin dhe mbështetjen e mësimdhënies në përputhje me rezultatet e të nxënit.</i></p> <p><i>Megjithatë, nga takimet me studentët dhe analizat përkatëse, evidentohet se praktika të tilla si mësimi i përbashkët me ciklin bachelor dhe mungesa e diferencimit të ngarkesës mësimore ndikojnë në përvetësimin e plotë të kompetencave të parashikuara për programin profesional. Gjithashtu, ndikimi i trajnimeve dhe përpjekjeve për inovacion pedagogjik nuk është ende i reflektuar qartë në përvojën e drejtpërdrejtë të studentëve.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon ndarjen e qartë të mësimdhënies sipas cikleve, forcimin e metodave interaktive me fokus tek studenti, si dhe matjen më efektive të ndikimit të nismave për përmirësim cilësor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

<p><b>Standardi III.2</b></p>	
<p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të</p>	<p>UET, ka të miratuar një Rregullore të përgjithshme institucionale dhe një rregullore të veçantë për programin</p>

<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>profesional në Menaxhim, ku janë të përcaktuara qartë mënyrat, kriteret dhe instrumentet e vlerësimit të studentëve. Këto rregullore ofrojnë qartësi mbi llojet e vlerësimeve (vlerësim i vazhdueshëm, provime, detyra kursi, etj.), peshën përkatëse në vlerësimin përfundimtar, si dhe procedurat për ankimim apo ri-vlerësim të notës.</p> <p>Këto dokumente janë të publikuara dhe të aksesueshme për studentët përmes platformës UET LMS, ku çdo pedagog ngarkon silabusin përkatës dhe informon studentët për mënyrën e vlerësimit, e konstatuar kjo edhe nga takimet me stafin akademik dhe studentet. Silabuset përfshijnë komponentët e vlerësimit sipas natyrës së lëndës dhe përcaktojnë qartë kriteret e në arritjen e rezultateve të të nxënit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Silabuset e lëndëve të programit profesional në Menaxhim përmbajnë rubrika të dedikuara për metodologjinë e vlerësimit të studentëve, ku përcaktohen komponentët e vlerësimit (përfshirë pjesëmarrjen, detyrat praktike, provimet etj.), si dhe përqindja e secilit komponent në notën përfundimtare.</p> <p>Këto informacione i komunikohen studentëve në fillim të çdo semestri përmes prezantimit të silabusit nga pedagogu përkatës, në përputhje me praktikat e institucionalizuara dhe me manualin e përdorimit të platformës UET LMS, ku silabuset ngarkohen në mënyrë të detyrueshme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p>	<p>Programi profesional në Menaxhim i UET parashikon një vlerësim të kombinuar të njohurive teorike dhe aftësive praktike përmes një game të gjerë formash, si provimet me shkrim, prezantimet, detyrat praktike, projektet në grup, dhe përfshirja në praktika profesionale të organizuara. Kjo shumëllojshmëri metodash vlerësimi është e dokumentuar në silabuset e lëndëve dhe është pjesë e metodologjisë institucionale të mësimdhënies.</p> <p>Për lëndët me karakter profesional dhe praktik, projektet dhe detyrat specifike zënë një peshë të konsiderueshme në vlerësimin përfundimtar të studentëve, duke u dhënë mundësinë të demonstrojnë aplikimin e njohurive në situata të ngjashme me ato të tregut të punës.</p> <p>Gjithashtu, pjesëmarrja në praktikë profesionale është një element thelbësor i procesit të vlerësimit, i cili dokumentohet përmes formularëve dhe vlerësimeve nga punëdhënësit apo supervizorët praktik.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se Programi Profesional 2-vjeçar në Menaxhim në UET ka ngritur struktura të qarta për vlerësimin e studentëve, të</i></p>

	<i>dokumentuara në rregullore dhe silabuse të aksesueshme për studentët. Janë të pranishme metoda të ndryshme vlerësimi që mbulojnë aspektet teorike dhe praktike të programit, duke i dhënë mundësi studentëve të demonstrojnë në mënyrë të plotë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulet.	<p>Procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale në Programin Profesional 2-vjeçar në Menaxhim është i strukturuar për t'u zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik. Kjo evidentohet qartë në syllabuset e lëndëve, ku përcaktohen komponentët e vlerësimit (si provimet, prezantimet, detyrat individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrja aktive), së bashku me peshën e secilit në notën përfundimtare.</p> <p>Secili titullar i lëndës ka përgjegjësinë për të zbatuar këtë metodologji të vlerësimit, duke siguruar që rezultatet të jenë në përputhje me objektivat e të nxënit dhe me transparencë ndaj studentëve. Kjo qasje ndihmon në monitorimin e vazhdueshëm të progresit të studentëve dhe i jep atyre mundësinë për të përmirësuar performancën gjatë gjithë semestrit.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>UET ka në funksion platformën elektronike UET LMS, e cila përdoret për publikimin e materialeve mësimore, ngarkimin e detyrave dhe menaxhimin e komponentëve të vlerësimit nga pedagogët. Kjo platformë mbështet transparencën dhe gjurmueshmërinë në procesin e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p> <p>Nga takimet e GVJ me studentët u evidentua se procesi i testimeve përfundimtare zhvillohet në formë të sekretuar, përmes një sistemi ku teza e provimit nuk mban emrin e studentit, por është e identifikuar me barkod. Kjo metodë kontribuon në rritjen e objektivitetit të vlerësimit, shmangien e çdo forme abuzimi dhe garantimin e trajtimit të barabartë të studentëve.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi	Vlerësimi përfundimtar i çdo lënde në Programin Profesional në

<p>përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Menaxhim në UET zhvillohet në përputhje me strukturën e përcaktuar në syllabuset përkatëse, të cilat janë të hartuara sipas modelit standard të aprovuar nga institucionet përkatëse të arsimit të lartë në Shqipëri dhe në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018, që përcakton kornizën ligjore për ndërtimin dhe vlerësimin e moduleve në arsimin e lartë.</p> <p>Syllabuset përmbajnë qartësisht komponentët e vlerësimit, peshat përkatëse dhe mënyrat e grumbullimit të pikëve, si dhe afatet e dorëzimit të detyrave, duke garantuar transparencë dhe parashikueshmëri për studentët.</p> <p>Nga dokumentacioni i paraqitur dhe verifikimi i praktikave vlerësuese, rezultojnë se vlerësimi përfundimtar bazohet në komponentët e parashikuar në syllabus, përfshirë rezultatet e vlerësimit të vazhdueshëm dhe të testimit final. Kjo praktikë mbështet përputhjen me standardet ligjore dhe promovon një kulturë të drejtësisë dhe meritës akademike.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Feedback-u u jepet në mënyrë të diferencuar studentëve nga pedagogët, zakonisht në format verbal gjatë leksioneve ose konsultimeve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>UET ka të përcaktuar në Kodin e Etikës dhe në rregulloret institucionale parimet për ndalimin e plagjiaturës dhe kopjimit gjatë provimeve apo dorëzimit të detyrave. Në dokumentet rregullatore theksohet se shkeljet e integritetit akademik përbëjnë vepra të dënueshme, dhe janë të sanksionuara me masa administrative që shkojnë deri në përjashtimin nga programi i studimit.</p> <p>Gjithashtu, praktika e zhvillimit të provimeve në formë të sekretuar përmes barkodit kontribuon në ruajtjen e anonimitetit të vlerësimit dhe shmangien e favorizimeve apo padrejtësisë.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Në dokumentacionin institucional dhe syllabuset e lëndëve të programit, parashikohet qartë që rezultatet e provimeve dhe detyrave të vlerësimit publikohen në përputhje me kalendarin akademik dhe rregulloret e brendshme, duke garantuar transparencë dhe respektim të afateve kohore.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar për çdo komponent të lëndës mbështetet</p>

	<p>në meritë dhe është i dokumentuar në sistemin LMS, çka mundëson gjurmueshmëri dhe akses të drejtpërdrejtë nga studentët. Po ashtu, praktika e përdorimit të barkodit në testime forcon ndjeshëm elementin e paanshmërisë në procesin e vlerësimit.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>UET, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të institucionit, garanton të drejtën e studentëve për të kërkuar shpjegim dhe rishikim të vlerësimeve, në rast se ato konsiderohen të pasakta apo të padrejta. Procesi i ankimit është i parashikuar qartë dhe formalizohet përmes formularëve zyrtarë dhe afateve të përcaktuara në dokumentacionin rregullator.</p> <p>Gjithashtu, përmes platformës LMS, studentët kanë akses të drejtpërdrejtë në rezultatet e tyre dhe mund të ngrënë pyetje ose shqetësime në lidhje me mënyrën e vlerësimit në kohë reale. Formulari për ankesat e studentëve dhe praktikën e dokumentuara tregojnë se kjo e drejtë është funksionale dhe e njohur institucionalisht, e konstatuar kjo edhe nga takimi i GVJ me studentet.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>UET ka të përcaktuara në rregulloret institucionale procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe ankimeve të studentëve, të cilat përfshijnë fillimisht vlerësimin nga komisioni i lëndës, dhe më pas nga një komision i posaçëm ankimor, nëse është e nevojshme. Këto komisione janë të mandatuara të shqyrtojnë me objektivitet çdo rast, në përputhje me standardet ligjore dhe etike të institucionit.</p> <p>Procedura është e dokumentuar dhe e arkivuar në mënyrë të strukturuar, dhe përdorimi i formulareve zyrtare për ankesa ndihmon në mbajtjen e një gjurme të qartë të rasteve të trajtuara. Komunikimi me studentët realizohet zyrtarisht dhe garanton që palët të jenë të informuara për vendimmarrjen dhe rrjedhën e procesit.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe takimet e zhvilluara me aktorët përkatës, rezulton se UET ka struktura dhe rregullore funksionale që mbështesin një sistem të drejtë dhe transparent të testimit dhe vlerësimit të studentëve. Janë në funksion syllabuset me përshkrim të qartë të komponentëve të vlerësimit, zhvillimi i provimeve realizohet me barazi përmes procesit të sekretuar dhe përdorimit të barkodeve, si dhe është garantuar e drejta për ankim dhe rishikim të notës. Gjithashtu, janë dokumentuar praktikën e shqyrtimit të ankesave përmes komisioneve përkatëse.</i></p>

	<i>Megjithatë, mbetet e nevojshme përmirësimi i praktikave të dhënies së feedback-ut të strukturuar, përdorimi më sistematik i mjeteve për identifikimin e plagjiaturës, si dhe rritja e ndërgjegjësimit të studentëve mbi procedurat e ankimit dhe afatet përkatëse.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit tregon përpjekje për të siguruar thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale e specifike të studentëve, përmes përfshirjes në praktika profesionale dhe aktivitete ndërvepruese si konferenca shkencore, panairë pune, forume dhe projekte të financuara nga BE, të evidentuara në kalendarët e aktiviteteve për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të ndryshme si Deloitte, Cyber Morfosis, HR Club, si dhe organizimi i aktiviteteve si “Shkolla e Inovacionit” dhe “Panairi i Karrierës” tregojnë për orientimin drejt përgatitjes praktike dhe profesionale të studentëve.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi Profesional 2-vjeçar në Menaxhim garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të rëndësishme si teknologjia e informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Këto komponentë kurrikularë ofrojnë një bazë të strukturuar për zhvillimin e kompetencave të kërkuara në tregun e punës.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin	Programi Profesional 2-vjeçar në Menaxhim paraqet kompetencat dhe aftësitë që studenti pritet të fitojë në përmbajtjen e syllabuseve të çdo lënde, të ndërtuara sipas formatit standard në përputhje me kërkesat e VKM nr.41/2018. Syllabuset përfshijnë qartë rezultatet e të nxënit dhe detyrimet përmbyllëse të lëndës, duke i orientuar studentët që në fillim të ciklit mësimor mbi qëllimet formuese të çdo moduli.  Nga dokumentet e mbledhura dhe shqyrtimi i syllabuseve rezulton se procesi mësimor përfundon me një analizë të



e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.	arritjeve të studentëve, përmes diskutimeve përmbledhëse, projektit final, ose provimit përfundimtar. Për më tepër, disa syllabuse parashikojnë diskutime për aplikimin e njohurive në kontekste reale, çka është një tregues pozitiv i orientimit praktik dhe ndihmon në përgatitjen profesionale të studentit.
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Programi Profesional 2-vjeçar në Menaxhim synon mësimdhënie të bazuar në kompetenca, të pasqyruar në planin mësimor dhe syllabuset, ku përfshihen lëndë me komponentë praktikë dhe aplikativ si “Praktikë dhe zhvillim studentit”, “Provim formimi/Projekt profesional”, dhe lëndë me metoda të ndërveprimit si punë në grup apo analiza çështjesh praktike. Kjo strukturë mbështet zhvillimin e kompetencave përmes integritit të dijes teorike me zbatime praktike në situata të ngjashme me tregun e punës.  Gjithashtu, bashkëpunimi me institucione partnere për realizimin e praktikave profesionale (të dokumentuara në marrëveshje bashkëpunimi) dhe mundësitë e pjesëmarrjes në leksione të hapura me aktorë të jashtëm, përbëjnë një hap pozitiv në drejtim të ndërthurjes së formave të mësimdhënies me realitetin profesional.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Programi Profesional në Menaxhim përfshin aktivitete të organizuara nga personeli akademik, si leksione të hapura, konferenca dhe seminare tematike, ku trajtohen zhvillime aktuale të menaxhimit dhe praktikës së biznesit. Këto aktivitete janë të dokumentuara në kalendarët e aktiviteteve për vitet akademike 2022–2023 dhe 2023–2024 dhe përfshijnë edhe pjesëmarrje të aktorëve nga tregu i punës apo profesionistë të fushës.  Gjithashtu, nga evidencat e bashkëngjitura nga institucioni, përfshihen kontributet e pedagogëve me kontratë dhe stafit efektiv në zhvillimin e seminareve brenda auditoreve të UET, duke u përpjekur të lidhin teorinë me përditësimet në teknologji dhe kërkesat e tregut.
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se programi profesional 2-vjeçar në Menaxhim ka një bazë kurrikulare të përshtatur për zhvillimin e kompetencave profesionale dhe ndërvepruese, ku përfshihen lëndë të orientuara drejt praktikës, teknologjisë së informacionit, dhe komunikimit. Programi mbështetet në bashkëpunime me institucione dhe kompani për praktikat profesionale, dhe ofron aktivitete si leksione të hapura dhe seminare të zhvilluara nga stafi akademik.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	<p>Institucioni ka të hartuar një procedurë të qartë për detyrimet përmbyllëse të studentëve, e cila përfshihet në dokumentin zyrtar “Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit”. Ky dokument specifikon qartë hapat që studenti duhet të ndjekë për përgatitjen dhe paraqitjen e projektit përfundimtar, duke përfshirë zgjedhjen e temës, udhëzimin nga pedagogu, afatet kohore, si dhe mënyrën e vlerësimit.</p> <p>Për më tepër, procedurat janë të harmonizuara me formatin e syllabusit dhe janë bërë të aksesueshme për studentët përmes rregulloreve institucionale dhe komunikimeve zyrtare, duke garantuar transparencë në proces.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik pranë Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut ofrojnë mbështetje për studentët në përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse përmes udhëzimeve të dokumentuara dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me pedagogët udhëheqës. Dokumenti “Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” parashikon qartë fazat e përgatitjes së projektit përfundimtar, si dhe detajon rolin e udhëheqësit akademik, i cili duhet të orientojë studentin në përzgjedhjen dhe zhvillimin e temës.</p> <p>Gjithashtu, studentët pajisen me informacione rreth formatimit të punës, afateve kohore dhe procedurave të dorëzimit përmes komunikimeve të brendshme apo përmes sistemit institucional (LMS). Kjo tregon një qasje sistematike në mbështetjen e studentit përgjatë procesit të diplomimit.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë	<p>Provimi përfundimtar i Programit Profesional 2-vjeçar në Menaxhim administrohet nga një komision i posaçëm, i ngritur sipas procedurave të përcaktuara në dokumentin institucional “Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit”. Ky komision ka për detyrë të vlerësojë studentin në bazë të përmbajtjeve të përvetësuara gjatë gjithë ciklit të studimeve, duke u mbështetur në testimin e njohurive të fituara nga të gjitha lëndët/modulet, në</p>

<p>të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>përputhje me peshën dhe rëndësinë që ato zënë në program.</p> <p>Forma e testimit është e unifikuar dhe e përcaktuar në formatin e tezës përfundimtare dhe përfshin elemente të njohurive teorike dhe praktike, duke garantuar një vlerësim të plotë të kompetencave të fituara nga studenti. Kjo pasqyron një përputhje të mirë me kriteret e standardit, si dhe me kornizën ligjore dhe praktikën më të mira akademike.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Provimi përfundimtar i programit profesional 2-vjeçar në Menaxhim administrohet nga një komision i posaçëm, në përputhje me procedurat e përcaktuara në dokumentet institucionale. Komisioni vlerëson njohuritë e akumuluar gjatë gjithë programit në mënyrë të integruar, duke u mbështetur në peshën specifike të çdo moduli dhe duke përfshirë si komponentët teorikë, ashtu edhe ata praktikë.</p> <p>Forma e testimit është e standardizuar, transparente dhe synon të sigurojë një vlerësim të drejtë dhe gjithëpërfshirës të kompetencave të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni ofron mundësi të pjesshme për mbështetjen e studentëve në realizimin e praktikave profesionale dhe projekteve përfundimtare në përputhje me tematikën e fushës së menaxhimit. Përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, si dhe përfshirjes së praktikave në kurrikul, studentët kanë akses në mjedise jashtë auditiveve për të zhvilluar komponentë praktikë dhe analiza të rasteve konkrete.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të detyrimeve përmbyllëse, siç është projekti final ose provimi përfundimtar, studentët vlerësohen në mënyrë të dokumentuar dhe transparente me notë përfundimtare, në përputhje me procedurat e përcaktuara në dokumentet rregullative të institucionit. Nota reflekton rezultatet e arritura gjatë gjithë procesit të përgatitjes dhe prezantimit të punës përmbyllëse, si dhe respekton rregullat e barazisë dhe meritokracisë.</p> <p>Vlerësimi bëhet nga komisioni përkatës dhe është pjesë përbërëse e dosjes akademike të studentit, duke u bërë publik brenda afateve të përcaktuara.</p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të Programit Profesional 2-vjeçar në Menaxhim, institucioni i pajis studentët me “Diplomë Profesionale”, në përputhje me formatin dhe kërkesat e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe legjislacioni në fuqi. Përveç diplomës, studentëve u vihet në dispozicion edhe kopja zyrtare e planit mësimor dhe përshkrimi i programit të ndjekur, duke garantuar transparencë dhe mundësi për vërtetim të përmbajtjes së studimeve të kryera.</p> <p>Ky proces dokumentohet dhe zbatohet sipas rregulloreve dhe praktikave të miratuara të institucionit, duke respektuar integritetin akademik dhe të drejtën e studentit për të marrë njohje të plotë të arritjeve të tij akademike.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni zbaton procedura të qarta për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të studentëve, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe rregulloret e brendshme. Sekretaria mësimore dhe strukturat përkatëse mbajnë në arkivë të dhënat akademike të studentëve, duke përfshirë dosjen personale, rezultatet e provimeve, përmbajtjen e programit të ndjekur, si dhe kopjet e diplomave të lëshuara.</p> <p>Për më tepër, institucioni garanton aksesin zyrtar dhe të kontrolluar në këto dokumente kur kërkohen nga vetë studentët apo autoritete të tjera, duke respektuar parimet e transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e dokumentacionit institucional dhe takimet me aktorët përkatës, GVJ vlerëson se Programi Profesional 2-vjeçar në Menaxhim ka një strukturë të qartë dhe të dokumentuar për detyrimet përmblyëse të studentëve. Institucioni ka vendosur procedura për organizimin e provimeve finale, mbështet studentët gjatë përgatitjes së tyre dhe siguron vlerësim të drejtë, të bazuar në meritë dhe dokumentuar në mënyrë transparente. Diploma dhe certifikatat lëshohen sipas standardeve të miratuara, dhe dokumentacioni ruhet konform rregullave ligjore.</i></p> <p><i>Gjithsesi, GVJ rekomandon forcimin e përfshirjes aktive të të gjithë studentëve në praktika dhe analiza konkrete, si dhe përmirësimin e aksesit në burime të specializuara sipas temave përkatëse të diplomimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi III.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni ka hartuar dhe përdor udhëzues institucionalë për zhvillimin dhe aplikimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të përshtatura sipas fushave të studimit dhe specifikave të lëndëve/moduleve. Këto udhëzues orientohen nga praktikat bashkëkohore të mësimdhënies dhe janë të reflektuara në dokumente si formulari i vetëvlerësimit të personelit akademik dhe formatet e vlerësimit të pedagogëve nga studentët.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni ka në funksion një sërë mekanizmesh për monitorimin dhe vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Këto mekanizma përfshijnë vetëvlerësimin e personelit përmes formularëve të strukturuar (si “Formulari i vetëvlerësimit të performancës” – G-I-12-1), vlerësimin nga studentët përmes formateve të miratuara institucionale (si G-III-4-2), si dhe vlerësimin nga kolegët ose eprorët (G-III-4-1).  Rezultatet e këtyre vlerësimeve analizohen nga strukturat përgjegjëse dhe përdoren për identifikimin e nevojave për përmirësim, mbështetje apo trajnim shtesë për personelin.
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie në institucionin ofruer të Programit Profesional 2-vjeçar në Menaxhim, ndërmarrin vlerësime periodike të performancës së personelit akademik, si nëpërmjet vetëvlerësimit, ashtu edhe përmes vlerësimit nga studentët dhe eprorët. Rezultatet e këtyre vlerësimeve janë të dokumentuara dhe referuar materialeve të dorëzuara, ato përpunohen dhe ndahen me personelin përkatës, duke synuar reflektimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të mësimdhënies.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni ka krijuar mekanizma vlerësimi të performancës mësimdhënëse përmes formularëve të vetëvlerësimit, vlerësimeve nga studentët dhe nga kolegët, që përdoren për të identifikuar pikat e forta dhe nevojat për përmirësim të stafit akademik. Nga takimet e GVJ u konfirmuan praktika të formalizuara për promovimin e shembujve të praktikave të mira apo për shpërbllimin/nxitjen sistematike të pedagogëve me performancë të lartë.
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm</i>

	<i>për të ndërtuar dhe zbatuar një politikë për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, përmes përdorimit të udhëzuesve dhe mekanizmave të vlerësimit të personelit akademik. Mekanizmat e vetëvlerësimit, vlerësimit nga studentët dhe kolegët janë funksionalë dhe përbëjnë një bazë të mirë për analizën e performancës pedagogjike.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### **IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie dhe ecurinë e programit të studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim përmbush kërkesat ligjore në fuqi sa i takon nivelit të kualifikimit akademik. Stafi për tre vite 2022-2023 15PAE/4PAK 2023-2024 21 PAE/ 2 PAK 2024-2025 19PAE/3 PAK Stafi akademik në viti akademik 2022-2023 i angazhuar në programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim përbëhet nga 19 anëtarë staf akademik efektiv dhe me kontratë prej staf akademik efektiv PAE 3 anëtarë me titullin Profesor, 6 anëtarë me gradën shkencore Doktor i Shkencave dhe 3 anëtarë Master i Shkencave. Staf akademik me kontratë PAK përbëhet nga 4 anëtarë prej të cilëve 1 mban gradën Doktor i Shkencave

	<p>dhe 3 Master i Shkencave.</p> <p>Në vitin akademik 2023-2024 numri i anëtarëve të angazhuar është: PAE Staf akademik efektiv përbëhet nga 21 anëtarë prej të cilëve 4 janë profesorë, 2 profesorë të asociuar, 4 doktorë të shkencave dhe 11 master të shkencave. Ndërsa stafi akademik me kontratë përbëhet nga 2 anëtarë: 1 Profesor i Asociuar dhe 1 Master Shkencor.</p> <p>Në vitin akademik 2024-2025 stafi akademik përbëhet nga: stafi akademik efektiv prej 19 anëtarësh prej të cilëve 4 Profesorë, 2 Profesorë i Asociuar, 1 Doktor i Shkencave, 12 Master i Shkencave. Stafi akademik me kontrate përbëhet nga 3 anëtarë prej të cilëve 1 është Profesor i Asociuar dhe 2 Master i Shkencave (0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB programi DPM.pdf, Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2)).</p> <p>Po ashtu stafi akademik nga përmbatja e CV (20.CV E STAFIT - DP MENAXHIM PDF FILE.pdf) zotëron ekspertize të gjerë, por në dokumentat bashkëshoqërues mungon evidentimi i angazhimit dhe mbulimi me lëndë për stafin në mënyrë të specifikuar për programin Diplomë Profesionale në Menaxhim duke mos patur mundësi për të gjykuar për përshtatshmërinë e përkatësisë për fushën e stafit me lëndët dhe ngarkesës mësimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> <p>Sa i takon stafit ndihmës akademik/ administrativ jepet në nivel institucioni dhe jo në nivel programi apo departamenti dhe nuk mund të gjykohej më tej në përmbushjen e kriterit. (0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB programi DPM.pdf - Të dhëna sipas moshës për stafin akademik në vitin e fundit (Tabela 8)).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga gjykimi mbi dokumentat e vëna në dispozicion nuk mund të vlerësohet nëse personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Dokumenti i referuar (11.2. <i>Formulari i planifikimit të ngarkesës nga departamenti.pdf</i>) është i paplotësuar dhe referencat e tjera janë vetëm pjesë të rregulloreve pa ofruar evidencë në lidhje me ngarkesën, lëndën ose modulën dedikuar specifikisht programit Diplomë Profesionale në Menaxhim. . Edhe pse institucioni propozon përgjatë procesit të ofrojë të dhëna plotësuese nuk e ka realizuar atë Përgjatë procesit Institucioni pohon se mund të ofrojë dokumentacion shtesë, por duhet vënë në dukje se afati kohor</p>

	për të plotësuar të dhënat ka kaluar dhe ato nuk janë plotësuar me të dhëna të tjera në lidhje me plotësimin e kriterit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Institucioni garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim për të gjithë periudhën e akreditimit. Rregullorja e Burimeve Njerëzore garanton specifikat në lidhje me politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik, kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore, trajtimin e rasteve të ekselencës së personelit, kriteret dhe procedurat e marrjes lejë në institucion ( <i>11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.pdf</i> ). Stafi akademik ka relativisht qëndrueshmëri nga viti 2022- 2023 ku stafi përbëhet nga 15 staf akademik efekt dhe 4 staf akademik me kontrate, për vitin 2023-2024 stafi akademik efektiv përbëhet nga 21 anëtarë dhe stafi akademik me kontratë nga 2 anëtarë dhe në vitin 2024-2025 nga 19 anëtarë staf akademik efektiv dhe 3 me kontratë. <b>Nga informacioni në takim rezulton se janë përmbushur detyrimet në lidhje me kontratat e punësimit.</b>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura përmes rregullore së burimeve njerëzore. Në të specifikohet rekrutimi përmes të gjitha procedurave të njoftimit dhe konkursit sipas një praktikë që është ajo e lajmërimit të kandidatëve sipas një short liste dhe dorëzimi i dokumentacionit përmes një dosje që përmban kopje të diplomave dhe të certifikatave të notave, dy letra rekomandimi nga profesorë ose punëdhënës të mëparshëm, dy programe lëndësh (syllabus) të hartuara nga kandidati, përmbledhje të punimit të diplomës për kualifikimin më të lartë që kandidati ka fituar, kopje të kartës së identitetit dhe çdo dokument tjetër që vlerësohet i nevojshëm. Ky process garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikuar ( <i>11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.pdf</i> ).
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<b>Në lidhje me stafin ndihmës akademik/ administrativ jepet ne nivel institucioni dhe jo në nivel programi apo departamenti dhe nuk mund të gjykohet më tej në përmbushjen e kriterit (0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB programi DPM.pdf - Të dhëna sipas moshës për stafin akademik në vitin e fundit (Tabela 8)).</b>

<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni ka të përcaktuar në pjesë respektive të rregulloreve për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore mënyrën sesi mbledhjen, ruhet informacioni në lidhje me stafin akademik. Në referencën e vënë në dispozicion përcaktohen dokumentat që përmban dosja e një aplikanti për angazhim me kontratë duke përmbajtur dokumenta si: Kontrata individuale e punës, Formularin për vlerësimin e pedagogut (Nga Autoritetet Drejtuese, Nga studentët), CV-në (sipas formatit të BE-së), Dokument identifikimi (fotokopje e kartës së identitetit), Diplomë të arsimit të lartë të kryer, si dhe dokumenta të tjera që vërtetojnë kualifikime, specializime, shoqëruar me listë notash, dhe marrje gradash apo titujsh akademikë e shkencorë, kopje të noterizuara. Nëse diploma e kualifikimit më të lartë është marrë në një institucion jashtë vendit, ajo duhet të jetë e shoqëruar me vendimin e njohjes nga MASR, Leje nga punëdhënësi kryesor për mësimdhënie në UET, Vërtetim page, i cili duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e pedagogut, detyrën që kryen në institucion, NIPT-in e institucionit, pagën bruto mbi bazën e të cilës llogariten kontributet, data e lëshimit, Deklaratën mbi statusin e të papunësuarit (Kur nuk është i angazhuar në marrëdhënie pune), Librezë shëndetësore, Raport mjeko ligjor, Certifikime të trajnimeve të ndryshme përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit (44.1. <i>Format dosje staf akademik me kohë të plotë.pdf</i>; 44.2. <i>Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm. Aktualisht UET disponon rreth 160 marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucional, por në kuadër të projektit 500+ secila nga 5 njësitë kryesore po punon për realizimin e 100 marrëveshjeve të bashkëpunimit. Ndërsa Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit posedon rreth 51 marrëveshje bashkëpunim (32. <i>Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale (Aneks Tabela 5 Dokumenti nr.ref.34) (2).pdf</i>; 0.2. <i>Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB programi DPM.pdf – Tabela 5</i>).</p> <p>Institucioni ka të përcaktuar në rregullore informacionin e nevojshëm në lidhje me procedurën e zhvillimit të praktikës profesionale duke filluar me hartimin silabusin e zhvillimit të praktikës në auditor, dhe kalendarin e zhvillimit të seancave, përzgjedhjen e ekspertëve të fushës që do të referojnë në auditor në seancat e programuara për çdo program studimi, të cilët duhet të jenë anëtarë të Bordeve të Tregut të Punës, ose UET Alumni. Po ashtu është e përcaktuar edhe përzgjedhja dhe kontaktimi me</p>

	<p>institucionet ku do të kryhen vizitat studimore në grup, mbikëqyrja dhe ndjekja e seancave me ekspertët e ftuar në auditor, caktimi i një pedagogu përgjegjës për çdo program studimi (si rregull caktohet pedagogu me statusin e këshilluesit të karrierës, i cili është përgjegjës edhe për zhvillimin e seancave të zhvillimit profesional dhe karrierës në auditor), mbikëqyrja dhe ndjekja e vizitave studimore të studentëve dhe kryerjen e praktikës në institucionet pritëse, duke caktuar pedagogun mbikëqyrës për çdo program studimi apo student, shpërndarja dhe mbledhja dokumentacionin e praktikës profesionale për çdo student, propozimi i përbërjes së Komisionit të Vlerësimit të praktikave, i cili bën vlerësimin përfundimtar, me notë dhe pikë, mbi atë çfarë kanë përfituar studentët gjatë praktikës.</p> <p>Po ashtu Zyra e Këshillimit të Karrierës, nëpërmjet parapërgatitjes së studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënies së informacionit e asistencës së nevojshme studentëve për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/ stazheve/ internshipeve të ofruara nga institucione partnere e më gjerë (32.1. Dokumenti B.1 Mbi praktikën profesionale.pdf).</p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Institucioni garanton që në mjediset e praktikës ka një personel mbikqyrës që angazhohet në realizimin e praktikës profesionale duke respektuar marrëveshjen e lidhur midis institucioneve (32.1. Dokumenti B.1 Mbi praktikën profesionale.pdf).</p> <p><b>Megjithatë duhet të sigurohej praktikisht një listë e stafit që është caktuar për mbikqyrjen e tyre apo dokumentave që institucioni pritë jep në përfundim të praktikës profesionale</b></p> <p>Përgjatë procesit Institucioni pohon se mund të ofrojë dokumentacion shtesë, por duhet vënë në dukje se afati kohor për të plotësuar të dhënat ka kaluar dhe ato nuk janë plotësuar me të dhëna të tjera në lidhje me plotësimin e kriterit..</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga dokumentat bashkëshoqërues mungon evidentimi i angazhimit dhe mbulimi me lëndë për stafin në mënyrë të specifikuar për programin Diplomë Profesionale në Menaxhim duke mos patur mundësi për të gjykuar për përshtatshmërinë e përkatësisë për fushën e stafit me lëndët dhe ngarkesës mësimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</i></p> <p><i>Stafi ndihmës akademik/ administrativ jepet në nivel institucioni dhe jo në nivel programi apo departamenti dhe nuk mund të gjykohej më tej në përmbushjen e kriterit në fjalë.</i></p> <p><i>Institucioni përmbush detyrimet në lidhje me kontratat e punësimit.</i></p>

	Do duhet të sigurohej praktikisht një listë e stafit që është caktuar për mbikqyrjen e tyre apo dokumentave që institucioni pritë jep në përfundim të praktikës profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore si 14 salla leksioni me kapacitet 1068 vende, 18 salla seminari me kapacitet 493 vende, 7 laboratorë informatike dhe 1 sallë internet. Numri dhe përberja e studentëve të programit siguron një akomodim të përshtatshëm dhe të plotë për kapacitetet e mësipërme. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program nuk e kalon numri 21 dhe kapacitetet për zhvillimin e veprimtarisë mësimore janë të plota. (42. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. "Xhanfize Keko".pdf</i> ; 42.1 <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. "Xhanfize Keko" (Tabela 16).pdf</i> )
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Institucioni ofron mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e këtij programi studimi me karakter profesional me salla leksioni, klasa seminari, laboratorë informatike për module që kërkojnë aplikim të njohurive teorike. Sallat janë të pajisura me mjete audio visive si kompjutera, projektorë për të mundësuar interaktivitetin me studentin. Po ashtu student ka mjediset të tjera si zyra informimi, klube studentpre për aktivitetet të tjera. Infrastruktura plotëson kushtet e kondicionimit për të garantuar një mjedis të sigurtë dhe të përshtatshëm për mësimdhënie dhe aktivitetet praktik. Mjediset po ashtu janë të pajisura me pajisje dhe akses në internet për të rritur interaktivitetin gjatë procesit mësimor (42.1 <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. "Xhanfize Keko" (Tabela 16).pdf</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të	Institucioni ka mundësuar për programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim Laboratorë informatike për bazat e praktikës me të gjitha mjetet e nevojshme si kompjutera video projektorë, të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të

programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. Kontrolli dhe mirëmbajtja e tyre garantohet nga zyra e teknologjisë së informacionit. (42.1 <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko” (Tabela 16).pdf</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni ka vënë në dispozicion të programeve të studimit duke përfshirë edhe programin Diplomë Profesionale në Menaxhim disa laboratorë të pajisur me mjetet e duhura për zhvillimin e mësimin. Institucioni zotëron 11 laboratorë mësimorë dhe 7 laboratorë informatike që operojnë me programet Windoës 10, Ms Teams, Access, Communicator. UET ka investuar në sistemin MOODLE (UET LMS), përmes së cilit studenti ka mundësi të marrë informacione në lidhje me ecurinë akademike të tij. (42.1 <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko” (Tabela 16).pdf</i> ).			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Institucioni dhe Departamenti i Menaxhimit, Marketingut dhe Zhvillimit përmes bibliotekës ofron literaturë bazë dhe ndihmëse. Informacioni ofrohet në gjuhën shqipe duke garantuar marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim. Edhe në rregulloren e përcaktuar për funksionimin e bibliotekës është e përcaktuar së në fondin e saj biblioteka duhet të ketë domosdoshmërisht tekstet bazë/literatura bazë për çdo program studimi, sipas listës së përpiluar nga departamentet. Fondi i bibliotekës është i pasur me larmi tekstesh, artikuj shkencor, manual praktike në ndihmë të studentit për marrjen e njohurive dhe realizimin e detyrave të përcaktuara. Biblioteka ofron një

	<p>fond prej 1708 titujsh në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj. Në bashkëpunim me Drejtuesit e Departamenteve, Biblioteka harton listën e pasurimit të vazhdueshëm të fondit të saj, para fillimit të çdo viti akademik dhe ia kalon atë Administratorit për miratimin e blerjes së tyre. (45. <i>Inventari i teksteve ne Bibliotekë për fushën e programit të studimit-Menaxhim.pdf</i>; 45.1. <i>Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Praktika e operimit të Institucionit i vë në dispozicion studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. Për mënyrën e funksionimit dhe kryerjen e aktiviteteve biblioteka ofrin 2 salla me sipërfaqe 134m<sup>2</sup> me 45 vende leximi, e pajisur me kompjutera me mundësi aksesimi për të gjithë studentët. (45. <i>Inventari i teksteve ne Bibliotekë për fushën e programit të studimit-Menaxhim.pdf</i>; 45.1. <i>Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pasur me një fond të fizik botimesh dhe gjykuar nga lista e titujve të vënë në dispozicion në raport, ky fond përbëhet nga 116 tituj të dedikuar për programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim. (45. <i>Inventari i teksteve ne Bibliotekë për fushën e programit të studimit-Menaxhim.pdf</i>).</p> <p>Mënyra e operimit në lidhje me sigurimin e informacionit bazë për studim për studentët e programit është ajo e ofrimit të leksioneve të përgatitura nga pedagogu përmes platformës LMS ku studentët mund të aksesojnë lehtësisht materialet e nevojshme. <b>Nga ana tjetër gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës u vu re se ka një mospërputhje midis titujve të vendosur në syllabuse dhe fondit të vënë në dispozicion të studentit. Për këtë duhet një rakordim më i saktë i syllabusit ose literaturës së ofruar në mjediset fizike të bibliotekës.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm nuk e dokumenton qartësisht plotësimin e këtij kriteri, por nga vizita, institucioni ofron kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në mjediset e bibliotekës. Biblioteka në mjediset universitare ishte e pajisur me kompjuter, duke të mbuluar me sinjal internet për përdorim pa kufizim nga ana e studentëve të shërbimeve të bibliotekës.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	

<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e institucionit funksionin në shërbim të studentëve duke u përshtatur me oraret e zhvillimit të mësimi. Ajo është e hapur 6 ditë të javës dhe funksionon duke patur parasysh numrin e studentëve dhe kapacitetet e bibliotekës. Orari i funksionimit është i tillë që përgjatë ditëve të javës orari është 9.00-20.00 dhe ditën e shtunë 10.00-17.00. Gjatë periudhës së sezonit të provimeve shërbimi i bibliotekës shtrihet në një periudhë më të gjatë kohe (45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf)</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>Institucioni ka të përcaktuar në rregullore rolin dhe rëndësinë e bibliotekës duke specifikuar ndjekjen dhe raportimin mbi aktivitetin e saj. Drejtuesi i bibliotekës ka të përcaktuar në rregullore evidentimin dhe raportimin në Rektorat për çështje që kanë të bëjnë me anëtarësimin, me frekuentimin e Bibliotekës dhe me qarkullimin e materialeve të saj dhe sugjeron masat që mund të merren për përmirësimin e shërbimit bibliotekar në UET. (45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf). <b>Pavarësisht kësaj në raportimin nuk del në pah mënyra sesi është realizuar kjo apo dokumentimi i një raporti të gjeneruar nga ky proces për të gjykuar në lidhje me realizimin konkret të kësaj veprimtarie.</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni përmes bibliotekës ofron literaturë bazë dhe ndihmëse. Fondi i bibliotekës është i pasur me larmi tekstesh, artikuj shkencor, manual praktike në ndihmë të studentit për marrjen e njohurive dhe realizimin e detyrave të përcaktuara. Praktika e operimit të Institucionit i vë në dispozicion studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës u vu re se ka një mospërputhje midis titujve të vendosur në syllabuse dhe fondit të vënë në dispozicion të studentit. Për këtë duhet një rakordim më i saktë i syllabusit ose literaturës së ofruar në mjediset fizike të bibliotekës.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	Institucioni disponon sistem të menaxhimit të të dhënave në lidhje me studentët. Kjo gje realizohet nga Zyra e Regjistrimit të Studentëve dhe Sekretaria Mësimore duke filluar nga regjistrimi i tyre në program e deri në lëshimin e diplomës. Mbajtja e të dhënave realizohet në regjistrin fizik dhe atë elektronik të Sistemit të Menaxhimit të Universitetit (UMIS). Për të thjeshtuar dhe vënë në funksionim të gjithë procesin UET instruktos përmes modulit metodologjik dhe sistemin e menaxhimit të Universitetit (UMIS). Si për stafin ashtu dhe për studentët vihet në dispozicion manuali i funksionimit të sistemit LMS. (9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf; 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf).
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit LMS administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Përveç kësaj, është ndërtuar një folder me Setin e dokumentave strategjik të institucionit për të rritur shkëmbimin e informacionit dhe transparencën e tij (46.2 UET LMS - Guide per pedagogun.pdf; 46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf).
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit në Universitetin Europian të Tiranës dhe specifikisht stafit të programit Diplomë Profesionale në Menaxhim, siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Institucioni ofron akses në Dosjen Dokumenta të UET për të gjithë elementët që lidhen me rregulloret dhe legjislacionin në fuqi. Studentët aksesojnë informacion përmes platformës LMS, ndërsa të dhënat personale të studentëve regjistrohen dhe ruhen në sistemin elektronik të menaxhimit të universitetit (46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf).
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe	Sistemi i menaxhimit ka të integruar platformën LMS UET dhe Microsoft Teams për të mundësuar komunikimin virtual interaktiv për personelin dhe studentët. Këto platforma kanë mundësuar rritjen e shpejtësisë së komunikimit për të shkëmbyer informacion, njoftime, detyra, vlerësimin e komponentëve të

shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	lëndës dhe organizimin e pyetjeve dhe kërkesave të ndryshme në lidhje me procesin mësimor. Për të mundësuar këtë institucioni ka konceptuar 2 manuale të përdorimit të platformave LMS për stafin akademik dhe studentët. Po ashtu për të ruajtur kriteret e konfidencialitetit stafit dhe studentët krijojnë llogaritë e tyre për lehtësimin e përdorimit të tyre (46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf).			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi LMS i UET krijon mundësinë e monitorit në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe i mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Kjo gjë realizohet në fund të çdo semestri. Nga procesi i monitorimit është mundësuar përmirësimi i vendimarrjeve për ecurinë e vazhdueshme të aktivitetit akademik.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Institucioni ofron informacion në lidhje me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme. Në këto faqe mund të gjendet informacion në lidhje jo vetëm me aktivitetet akademike dhe kërkimore por edhe vizitat, aktivitetet e karakterit informues, aktivitetet në kuadër të projekteve vecanërisht ato Erasmus etj. Informacioni i ofruar siguron transparencë për personelin akademik, studentët dhe aktoret e tjerë të përfshirë në marrëdhënie me programin (47. Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës.pdf).			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni ka në funksion një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional të integruar që mundësojnë administrimin, informimin në kohë dhe monitorimin sistematik të të gjitha aspekteve të funksionimit të programit të studimit. Përdorimi i këtij sistemi kontribuon në rritjen e transparencës, efikasitetit dhe cilësisë së përgjithshme të veprimtarisë institucionale.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni harton një raport financiar të kostove të studentëve në përgjithësi dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. <b>Ky raport nuk ka të përcaktuar specifikisht kostot për studentët e programit Diplomë Profesionale në Menaxhim.</b> Burimi i financimit për mbarëvajtjen e programi janë tarifata e ndryshme të shkollimit, grantet për kërkim dhe projekte të ndryshme nga donatorë të huaj ku UET ka qenë partner. Për vlerësimin e gjendjes financiare institucioni ka bërë një auditim të përvitshëm duke hatuar një raport vjetor. Për të ruajtur qëndrueshmërinë e aktivitetit realizohet procesi krahasues midis viteve të ndryshme për të evidentuar problematikat e ndryshme (50.1. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime.pdf; 50.2 Pasqyrat Financiare 2023 me shënime.pdf; 50.3 RAPORT AUDITIMI Viti 2022.PDF; 50.4. RAPORT AUDITIMI_2023.PDF).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p><b>Plani i financimit i Universitetit Europian të Tiranës është konceptuar për të gjithë institucionin pa detajuar aspekte të dedikuara specifikisht Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit përgjegjës për programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim.</b> Ky plan përmban financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. Pasqyrat financiare përmbajnë informacion në lidhje me kontabilizimin e atë ardhurave dhe shpenzimeve. Plani i financimit garanton burimet e majftueshme dhe të qëndrueshme financiare të cilat nevojiten për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit (50. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme (Tabela 18.2).pdf).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Pas këtij procesi realizohet analiza e detajuar e burimeve të financimit duke siguruar që të gjitha aktivitetet në përputhje me objektivat e programit. Procesi i auditimit realizohet në dy drejtime: Auditimi i brendshëm, realizohet nga njësitë e auditimit të</p>

	<p>brendshëm së bashku me auditimin e jashtëm që realizohet nga auditues të zgjedhur nga Ministria e Arsimit. Përzgjedhja e subjektit që kryen auditimin e jashtëm përmbush kriteret për kryerjen e ekspertizës. Audituesi realizon vlerësimin e pasqyrave financiare dhe analizën financiare duke raportuar për pozicionin financiar të institucionit në përputhje me Standartet Kombëtar të Kontabilitetit (50.1. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime.pdf; 50.2 Pasqyrat Financiare 2023 me shënime.pdf; 50.3 RAPORT AUDITIMI Viti 2022.PDF; 50.4. RAPORT AUDITIMI_2023.PDF).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, në funksion të transparencës Universiteti European i Tiranës raporton deri në nivelin e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut përgjegjës për programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim, mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Në këtë raportim realizohet analiza e plotë e shpenzimeve të kryera. Alokimi i burimeve dhe përdorimi i tyre. Në këtë raportim realizohet edhe një proces krahasimi midis buxhetit të miratuar dhe atij të realizuar shoqëruar me rekomandime për përmirësimin e menaxhimit financiar të mëvonshëm. Gjithsesi, në <b>Raportin e Vlerësimit të Brendshëm nuk ka asnjë reference për mënyrën se si institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të programit. Buxheti financiar harohet në muajin tetor të çdo viti dhe miratohet nga aksionerët e institucionit. Për kryerjen e buxhetimit ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës duke hartuar një projekt buxhet me raporte të drejta midis të ardhurave dhe shpenzimeve. Analiza sistematike rreth efikasitetit dhe kostove financiare pas raporteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm garanton ndërhyrje të posaçme dhe diversifikim eventuale të financimit të programeve të studimeve në rast nevojë (50.1. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime.pdf; 50.2 Pasqyrat Financiare 2023 me shënime.pdf; 50.3 RAPORT AUDITIMI Viti 2022.PDF; 50.4. RAPORT AUDITIMI_2023.PDF).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetjen financiare për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Por ky raport nuk ka të përcaktuar specifikisht kostot për studentët e programit Diplomë Profesionale në Menaxhim.</i></p>

	<i>Gjithashtu, plani i financimit i institucionit është konceptuar për të gjithë institucionin pa detajuar aspekte të dedikuara specifikisht Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit përgjegjës për programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim, nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore.</p> <p>Numri i studnteve per tre vitet e fundit jane</p> <p>2022-2023 16 studentë</p> <p>2023-2024 18 studentë</p> <p>2024-2025 19 studentë</p> <p>Këto politika janë të përcaktuara në Statuti i UET si edhe rregulloren e studimit. Në këtë dokument janë të përcaktuara kreditet e programit (120 kredite), koha e zhvillimit, kriteret e pranimi, gjuha e zhvillimit etj (5. RREGULLORE UET.pdf; 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimi të studentëve.pdf; 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf).</p>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë	Institucioni ka përcaktuar politika dhe procedura nga hyrja në dalje që garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Këto kriteret nuk përjashtojnë apo diskriminojnë kandidatët dhe

<p>kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>mbështeten në përcaktimet dhe udhëzimet ligjore. Për të garantuar procesin institucioni i publikon kriteret e pranimit të studentëve në faqen e web në përputhje me politikat institucionale. Po ashtu informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit bëhet publik online (5. <i>RREGULLORE UET.pdf</i>; 7. <i>Rregullore_DP Menaxhim.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Institucioni harton dhe publikon në fillim të çdo viti akademik kriteret të qarta në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve për pranim në programin e studimeve Diplomë Profesionale në Menaxhim. Kriteret përmbledhin kriteret e pranimit, procedurën e aplikimi dhe vlerësimin e kandidatëve për të ruajtur meritokracinë në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve. Në programet e studimit të ofruara në UET pranohen shtetas shqiptar ose të huaj që plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga organet drejtuese të UET dhe strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore. Departamenti mund të vendosë edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve të cilat shpallen nga UET dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin. Kriteret dhe procedurat e hollësishme të pranimit të studentëve përcaktohen me dokumenta të vecantë (5. <i>RREGULLORE UET.pdf</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni ka të përcaktuara qartë kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Kjo realizohet përmes statutit dhe rregulloreve të departamentit dhe programit dhe janë të aksesueshme për publikun përmes website, ku informacioni ofrohet për të gjithë (5. <i>RREGULLORE UET.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni ka të mirëpërcaktuara përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve në programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim në rregulloren mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve për programet me karakter profesional. Institucioni ka parashikuar pika apo klauzola në lidhje kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, kryesisht të reduktimit të tarifës së studimit për të plotësuar dimensionin social të institucionit. Universiteti Europian i Tiranës ofron mundësinë për të përfituar bursa të plota ose të pjesshme studimi, mbi bazën e disa kriterëve</p>

	përzgjedhjeje, me synimin për të nxitur rezultate sa më të larta në studime, si dhe për të luajtur një rol të rëndësishëm social, duke u ardhur në ndihmë shtresave të diskriminuara dhe në nevojë (27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.pdf).			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Institucioni ka hartuar politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Ai ofron mundësinë e zbritjes së tarifës së shkollimit në rastin e aplikantëve/studentëve me rezultate të larta, ata nga e njëjta familje, si edhe në rastet kur pagesa bëhet e hershme. Detaje të hollësishme për kategoritë, llojet e bursave dhe reduktimeve, procedurën e aplikimit dhe kriteret për përfitimin e tyre, përcaktohen me dokument të veçantë (5. RREGULLORE UET.pdf)			
<b>Konkluzione</b>	Kriteri përmbushet, por të gjitha gjykimet janë dhënë mbi dokumenta në formë rregullore dhe dokumentash strategjik pa ofruar dokumenta konkrete sesa janë aplikuar në praktikë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Universiteti Europian i Tiranës krijon mundësinë përmes Zyrës së Pranimeve, Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit për të marrë informacion të plotë dhe të hollësishme në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik, numrit të krediteve dhe kriterëve për kalimin nga një vit akademik te tjetri. Ky këshillim ndihmon studentët për të orientuar studimin e tyre dhe përgatitjen për aktivitetin akademik (12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf). <b>Pavarësisht kësaj nuk vihet në dispozicion asnjë dokument i përpiluar me kriteret konkrete që mund të kenë kaluar në instance vendimarrëse.</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje	Universiteti Europian i Tiranës informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme

<p>me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme. Ky proces realizohet duke u mbështetur në rregullat dhe procedurat e parashikuara në statutin e UET dhe akteve të publikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Institucioni pranon transferim të studentëve në vitet pasuese nga institucione të tjera vendase ose të huaja publike ose jopublike si edhe lejon transferimin e studentëve të tij në institucione të tjera. Procedura e transferimit e cila fillon me kërkesën e studentëve në ekuivalentimin e lëndëve dhe moduleve dhe regjistrimin e tij, janë të përcaktuara në statut dhe rregullore. Për të ardhur në ndihmë të këtij procesi institucioni organizon grupe pune me përbërje studentë dhe staf akademik që rrisin vizibilitetin e institucionit në lidhje me orientimin e nxënësve (5. <i>RREGULLORE UET.pdf</i>; 7. <i>Rregullore_ DP Menaxhim.pdf</i>; 12. <i>Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i>; 28. <i>Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Procedurat dhe praktika e ndjekur nga institucioni përmes rregulloreve dhe zbatimit të vendimeve të ndryshme mundësojnë informimin e studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Kjo realizohet kryesisht përmes syllabusit të lëndëve në lidhje me përmbajtjen e programit, kriteret e vlerësimit, detyrat dhe mënyrën e realizimit të tyre (19.1. <i>A-III-5-1 Formati i Syllabusit , DP, Cikli i pare dhe dyte (shqip)-VKM 41 2018.pdf</i>; 19.1. <i>SYLLABUSET SHQIP.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti Europian i Tiranës informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit. Kjo realizohet përmes evidentimit të kalendarit të periudhës së diplomimit, komunikimit me email dhe kontakteve me kordinatorin e programit. Informimi përcakton kriteret dhe procedurat për shlyerjen e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar. Më specifikën e mbrojtjes së diplomës përmes një projekti praktik studentët informohen në lidhje me strukturën përmbajtjen dhe kriteret e vlerësimit. Po ashtu studentët marrin asistencën e nevojshme përmes seancave orientuese të organizuara për këtë qëllim (7. <i>Rregullore_ DP Menaxhim.pdf</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe</p>	<p>Universiteti Europian i Tiranës përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Kjo realizohet përmes zhvillimit të Ditëve të Hapura për çdo</p>

organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	njësi kryesore duke u njohur më nga afër me institucionin, stafin, mjedisin, programet etj. Në funksion të informimit studentët kanë në dispozicion edhe informacionin e ofruar në mënyrë të përditësuar nga website, broshurave dhe zyrave fizike (5. RREGULLORE UET.pdf).			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim jep informacion të plotë mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program..</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Specifikimet e rregullores së programit të studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim përcakton detyrimin për informimin e hollësishëm të studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. Që në momentin e aplikimit të regjistrimit dhe në vijim studentët informohen për kohëzgjatjen e programit, organizimin dhe strukturën e tij. Studentët informohen në lidhje më lëndët e detyrueshme dhe me zgjedhje, numrin e krediteve të nevojshme për përfundimin e studimeve, mënyrën e organizimit të mësimin, metodologjitë, praktikën profesionale etj. Po ashtu studentët vihen në kontakt me objektivat mësimor, kompetencat që duhet të fitohen në zhvillimin e programit të studimit. Informacioni është i publikuar edhe në UET LMS ku studentët kanë akses të plotë (7.Rregullore_DP Menaxhim.pdf; 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; 46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë	Këshillimi akademik dhe tutorial janë shërbime që ju ofrohen studentëve për t'i ndihmur ata të orientohen në arritjen e qëllimeve të tyre akademike, për të sqaruar cdo paqartësi ose vështirësi që mund të hasin për shlyerjen e detyrimeve në lëndët që frekutojnë. Studentët e programit të studimit kanë në dispozicion informacion dhe dokumentacion udhëzues të posaçëm për lëndët, përmbajtjen e tyre dhe veprimtaritë

formuese.	formuese. Këto informacione dhe dokumenta merren dhe gjenden në zyrën e sekretarisë dhe koordinatorëve në UET LMS dhe në web e institucionit (27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.pdf; 46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Universiteti European i Tiranës informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. Kjo realizohet përmes aktivitetit të Zyrës së Këshillimit të Karrierës duke i orientuar ata në mënyrën sesi hartohen CV-të, Si mund të orientohen për përfitojnë nga intervistat e punës, prezantimi i kalendarit të eventeve në lidhje m industrinë, zhvillimin e sondazheve për gjurmimin dhe analizimin e tregut të punës për ta (12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf).
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët e programit Diplomë Profesionale në Menaxhim u ofrohet informacioni i duhur mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të programit. Ata informohen mbi procesin mësimor nga sekretaria dhe kordinatorët në lidhje me orarin e mësimit, datat e provimeve, procedurat administrative etj. Po ashtu studentëve u ofrohet informacion dhe udhëzime nëpërmjet platformës UET LMS ku ata mund të shkëmbejnë informacion, materiale në lidhje me zhvillimin e lëndëve. Universiteti European i Tiranës ofron edhe procesin e Tutoriatit dhe ofron këshillim akademik të personalizuar për studentët sipas nevojave që ata kanë. Kjo është e përcaktuar në rregullore së bashku me seancat që ndihmojnë studentit për të zgjedhur dhe përmbushur detyrimet në programin e studimit (5. RREGULLORE UET.pdf; 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf).
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Universiteti European i Tiranës përmes strukturave dhe stafit informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. Në funksion të kësaj studenti merr informacion paraprak informues në auditor për zhvillimin e praktikës profesionale. Për të kordinuar këtë process studentët vihen në kontakt me ekspertë të fushës për të sjellë eksperiencën e tyre në lidhje me aktivitetin e funksionimit të biznesit. Përveç kësaj dita e zhvillimit të Panairit të Karrierës u jep mundësi studentëve të njihen me kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë për

	punësim.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Përgjithësisht, përmes rregullore tregohet se institucioni iu vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të mevojshëm për objektivat, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit..</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>
<b>Standardi V.4</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Universiteti Europian i Tiranës disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Këto informacioni janë të ruajtura në regjistra fizik dhe sisteme por edhe analiza të punës së departamentit me qëllim analizën dhe diskutimet e mbarëvajtjes së aktivitetit mësimor (27. <i>Cilesia hyrje dalje DP menaxhim (Tabela 21).pdf</i> )			
<b>Kriteri 2.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Ky system është UMIS, i cili menaxhohet në bashkëpunim edhe me UET LMS përmes Zyrës së Teknologjisë së Informacionit (9. <i>Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf</i> ; 46. <i>Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.pdf</i> ).			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe	Universiteti Europian i Tiranës ka të përcaktuar në mënyrë shumë të qartë përmes rregulloreve, akteve dhe kontrolleve dokumentimin e gjendjes dhe saktësisë së informacionit dhe mbajtjes së dokumentacionit për çdo student. Këto të dhëna gjenden në sekretarinë mësimore dhe zyrën e regjistrimit të studentëve. Sistemi i menaxhimit të informacionit UMIS është i strukturuar për të administruar dhe përpunuar me qëllim analizën e të dhënave të studentit (9. <i>Dokumenti E.I Mbi</i>			

saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<i>funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf).</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike, periodike në lidhje me programin Diplomë Profesionale në Menaxhim (38. <i>Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i> ). <b>Pavarësisht kësaj, këto raport kërkojnë një vështrim më të kujdesshëm në lidhje me ofrimin e të dhënave dhe analizave më të detajuar mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Këto të dhëna ruhen në dokumenta të copëtuara pa u përmbledhur në raportimin analitik të programit të studimit.</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni shpreh se mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna mbi numrin dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi i tyre e deri në diplomim, si dhe të dhëna mbi punësimit të tyre. Gjithashtu, njësia përgjegjëse për programin e studimit Diplomë profesionale në Menaxhim harton raporte analitike, periodike në lidhje me programin, por këto raport kërkojnë një vështrim më të kujdesshëm në lidhje me ofrimin e të dhënave dhe analizave më të detajuar mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre	Universiteti European i Tiranës parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Studentët organizohen në

<p>në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Këshillin Studentor, në grupet e vlerësimit të lëndëve dhe stafit akademik përmes vlerësimit online të pedagogut. Po ashtu studentët kanë mundësi të jenë pjesë e Senatit Akademik të institucionit, Dekanatit, Këshillit të Etikës dhe Komisioni të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (5. <i>RREGULLORE UET.pdf</i>). Gjithsesi, <b>institucioni do duhet të tregojë pjesëmarrjen e studenteve përmes dokumentave specifik dhe jo thjeshtë rregulloreve.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përmbatja e rregulloreve dhe Statutit të Universiteti European të Tiranës garanton në nenet e saj përfshirjen e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme (5. <i>RREGULLORE UET.pdf</i>) Institucioni organizon në fund të çdo muaji takim me senatorët e çdo grupi për të shprehur opinionet dhe shqetësimet e tyre. Opinioni i studentëve tërhiqet edhe nga mundësia që studentët kanë për të shfrytëzuar platformën LMS për të shprehur opinionin e tyre. Po ashtu ata plotësojnë formularët e pyetësorëve që dërgohen në adresat e tyre të emailit. Rrugët dhe instrumentet për të garantuar opinionin e studentëve të programit janë ndërtuar për të rritur përfshirjen e tyre në vendimmarrje.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. Ky proces është realizuar nëpërmjet angazhimit të studentëve në mbledhjet e hapura të departamentit. Ata mund të japin mendime në platformat UET LMS duke komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me departamentin. Kjo qasje krijon mundësinë për të mbledhur idetë dhe opinionin e studentëve në zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulës dhe aspekte të tjera të programit Po ashtu organizohen mbledhje me agjenda të përcaktuara ku studentët kanë mundësi të marrin pjesë dhe të shprehin opinionin e tyre. (12.5. <i>Mbledhje e hapur me studentet.pdf.pdf</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit,</p>	<p>Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Procesi i organizimit të provimit është i tillë që teza e provimit është e sekretuar dhe garanton anonimitetin e studentit. Studenti ka mundësi të njoftohet për vlerësimin gjatë semestrit</p>

rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	duke mundësuar jo vetëm transparencën por edhe rishikimin e tij. Procesi i rishikimit të provimit mbështetur në kërkesat e studentëve rrit komunikimin dhe transparencën duke ndërtuar marrëdhënie të drejta midis vlerësimit dhe studentit. Procedura e ankimimit realizohet përmes një procesi transparent përmes ngritjes së një komisioni ((5. <i>RREGULLORE UET.pdf</i> ; 7. <i>Rregullore_DP Menaxhim.pdf</i> ).			
<b>Konkluzione</b>	<i>Në lidhje me përfshin dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, me qëllim përmirësimin e programit të studimit dhe metodave të mësimdhënies, institucioni nuk ofron fakte, apo dokumentim sesi është realizuar konkretisht ky proces dhe cili ka qënë ndikimi i verifikueshëm i kësaj pjesëmarrje aktive të studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Universiteti European i Tiranës ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Kjo realizohet përmes dokumentacionit apo udhëzuesve të ndryshëm në lidhje me kalaendarin e mësimin, modulet dhe lëndët, veprimtaritë formuese dhe procesin akademik në tërësi. Këto informacione dhe seti i dokumentave mund të aksesohet në zyrën e sekretarisë, kordinatorit të programit, UET LMS, dhe website të Universitetit. Fillimi i semestrit është periudha e kohës kur organizohen javët e orientimit akademik për studentët. Zyra e këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit kanë rol të rëndësishëm në lidhje me këtë process (12. <i>Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i> ; 46.3. <i>UET LMS Guide per studentet.pdf</i> ).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin,	Universiteti European i Tiranës ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.

<p>ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, Këshillimi, Kordinatori i Programit janë të angazhuar në garantimin e një procesi të tillë. Po ashtu UET LMS dhe Microsoft Teams ofron informacione të përditësuara për procesin mësimor dhe programin e studimit. Informimi i Studentëve realizohet edhe nëpërmjet emailit si një instrument më i shpejtë i komunikimit (9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf; 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra e Këshillimit të Karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Ajo së bashku me Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve mbështet studentët për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe problematikat në lidhje me funksionimin e programit. Zyrat e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit u ofrojnë studentëve informacion të përditësuar për procesin mësimor dhe programin e studimit përmes UET LMS (12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra për Këshillimin e Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit dhe Shoqata e Alumni kanë qartësit të përcaktuar në rregulloren e funksionimit të tyre përmes rregulloreve të departamentit ndjekjen në mënyrë aktive studentët pas diplomimit duke mbledhur përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e studentëve të programit të studimit dhe ai vë në dispozicion studentëve organeve dhe autoritve drejtuese. Përmes kësaj zyre synohet të realizohet mbledhja e informacionit në lidhje me arritjet, kërkesat dhe sfidat që ndesh procesi në praktikë. Ky proces zhvillohet në momentin kur studenti tërheq diplomën pranë zyrave përkatëse duke plotësuar të dhënat në lidhje me mundësinë për gjurmimin e tij. Kjo databazë i vihet në dispozicion organeve vendimarrëse të institucionit</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni shpreh se ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Këto veprimtari tregohen vetëm përmes rregulloreve dhe jo përmes dokumentave që tregojnë praktikisht realizimin e</i></p>

	<i>tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Menaxhim” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Staf i akademik është i kualifikuar dhe përfshihet në trajnime të vazhdueshme për të përmirësuar kompetencat e tij didaktike dhe pedagogjike.
2. Program i studimit ka potencial për akomodimin e nxënësve të cilët nuk mund të ndjekin studime të ciklit të parë Bachelor, por që mund të zhvillojnë karrierën profesionale të tyre në një kohë të shkurtër dhe është i orientuar drejt nevojave të tregut të punës në fushën e menaxhimit.
3. Institucioni ka infrastrukturë dhe kapacitete të përshtatura mirë për realizimin e komponentëve teorikë dhe praktikë të programit, duke përfshirë auditorë të pajisur dhe ambiente mbështetëse për studentët.
4. Marrëveshjet e bashkëpunimit me biznesin, me potencial për orientimin e praktikave në lidhje me fushën profesionale të studentëve të programit të studimit.
5. Funkcionimi formal i strukturave për sigurimin e cilësisë dhe hartimi periodik i raporteve të monitorimit të procesit mësimor dhe të programit të studimit.
6. Përdorimi i platformave digjitale (UET LMS) që mundëson komunikim dhe akses në materialet mësimore në kohë reale.

**Pika të dobta**

1. Mungesa e qartësisë dhe fokusit për të ardhmen e programit duke mos iu kushtuar vëmendjen e duhur në elementët e organizmin e mësimorit, të cilët dukshëm zhvillohen bashkarisht me studimet e ciklit të parë Bachelor. (Standardi III 1 kriteri 2)
2. Përmbajtja e lëndëve në programin e studimit dhe ndërtimi i syllabusit duhen përshtatur dhe konceptuar në përputhje me kornizën së cilës i përket ky program studimi, në lidhje me nivelin e tematikave dhe thellësinë e përmbajtjes së tyre. (Standardi III 1 kriteri 6)
3. Studentët e programit shpesh ndjekin leksione së bashku me ciklin Bachelor, duke ndikuar negativisht në cilësinë e përfundimit të kompetencave të përcaktuara.
4. Nuk evidentohet përfshirje e qartë dhe efektive e studentëve në mobilitet apo aktivitete jashtë kurikulës. (Standardi I 2 kriteri 2)

**Rekomandime**



1. Të konceptohet programi i studimit me karakter profesional 2-vjeçar në Menaxhim në mënyrë të tillë që elementët, struktura, mësimi të zhvillohen të ndarë dhe në mënyrë të pavarur nga programe të ciklit të parë Bachelor.
2. Sigurimi i zbatimi në praktikë i raportit midis ngarkesës teorike dhe praktike, pasqyruar në kurrikulën e programit të mësimit.
3. Rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve duke ulur dhe përshtatur ngarkesën e njohurive me atë të cilit të studimit sipas nivelit 5 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.
4. Rishikimi i formës së syllabuseve për të përfshirë në to të gjithë elementët sipas përputhje me legjislacionin vendas në fuqi.
5. Realizimi i një studimi tregu të plotë dhe konkret, duke u dedikuar në programin e studimit me karakter profesional 2-vjeçar në Menaxhim, duke u fokusuar në përmbajtjen e të gjithë elementëve që do të përcaktonin objektivat, të ardhmen dhe avantazhet konkurruese të këtij programi studimi.
6. Të zhvillohet një mekanizëm i qëndrueshëm për ndjekjen e alumnit të programit profesional 2-vjeçar në Menaxhim, me qëllim vlerësimin e përputhjes së formimit profesional me tregun e punës dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës.

**Evaluation's conclusions for the professional study program "Management" provided by the Higher Education Institution "European University of Tirana"**

**Strengths and affirmations**

1. The academic staff is qualified and engaged in continuous training to enhance their didactic and pedagogical competencies.
2. The study program has the potential to accommodate students who are unable to pursue first-cycle Bachelor's studies but wish to develop their professional careers in a short period. It is oriented towards the needs of the labor market in the field of management.
3. The institution has the infrastructure and capacity to effectively support both the theoretical and practical components of the program, including well-equipped auditoriums and student support facilities.
4. Cooperation agreements with businesses provide opportunities for professional practice aligned with the students' field of study.
5. Quality assurance structures are formally established, with periodic monitoring reports prepared on the learning process and the study program.
6. Digital platforms (UET LMS) are used to facilitate communication and provide real-time access to learning materials.

### **Weaknesses**

- 1. There is a lack of clarity and focus regarding the future of the program, due to insufficient attention to the organizational aspects of teaching, which are currently closely aligned with the first-cycle Bachelor studies.**
- 2. The content of the courses and the design of the syllabi should be adapted and aligned with the framework of this specific study program, particularly in terms of topic level and content depth.**
- 3. Students in this program often attend lectures alongside those in the Bachelor cycle, which negatively impacts the quality of learning and the acquisition of the intended competencies.**
- 4. There is no clear or effective involvement of students in mobility initiatives or extracurricular activities.**

### **Recommendation**

- 1. Design the 2-year professional study program in Management so that its elements, structure, and learning outcomes are developed separately and independently from the first-cycle Bachelor programs.**
- 2. Ensure the practical implementation of the balance between theoretical and practical workload, as reflected in the study program's curriculum.**
- 3. Review the content of the syllabus by reducing and adapting the knowledge load to align with level 5 of the National Qualifications Framework.**
- 4. Review the format of the syllabus to include all required elements in accordance with the applicable local legislation.**
- 5. Conduct a comprehensive and focused market study dedicated to the 2-year professional study program in Management, emphasizing elements that define the objectives, future prospects, and competitive advantages of the program.**
- 6. Develop a sustainable mechanism for tracking alumni of the 2-year professional program in Management, aimed at assessing the relevance of professional training to the labor market and continuously improving the curriculum.**





**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>		X		
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>			X	

